

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7771 E mërkurë 23 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Dje Komisioni i Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit bëri me dije se që nga 1 korriku i këtij viti, qeveria nuk do të pranojë oferta për punë publike ...
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

Paraja që i merret së ardhmes



Dje në "Deutsche Welle"

Një atmosferë e sfocuar ndodhet gjithmonë në ajër; kur një çift i plakur ripërtërit premtimin e martesës. Kur kërkon të kapërcejë fazat e indiferencës ...
Vijon në faqen 21

Nga CHRISTIAN TRIPPE

Ndjenja pranverore gjermano-franceze



Surpriza, Rama bllokoi koncesionet PPP

Balluku, furtunë mbi "drejtorët e Gjyknurit". Ikën kreu i ARSSH pas skandalit tek Unaza e re

Sonila Qato në krye të Autoritetit Rrugor, shkarkohet edhe drejtori i portit të Durrësit

Kreu i Autoritetit Rrugor Shqiptar, drejtori i Autoritetit Portual Durrës dhe kreu i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë janë larguar brenda 48 orëve nga detyra. Vendimi për shkarkimin e kreut të ARSSH-së dhe kreut të Portit të Durrësit janë firmosur nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ...
Në faqen 2

EMRAT/ 1 MIJE TRASHËGIMTARËT QË MARRIN PARATË E DEMSHPERBLIMIT

TE PERNDJEKURIT, KUSH E PERFITON KESTIN E TRETË

Ministria e Financave: Edhe 2 javë kohë për të plotësuar dokumentet. Pasardhësit e ish-të dënuarve politikë duhet të hapin një llogari bankare dhe ta mbajnë aktive



(Në foto) Ish-të përndjekur politikë gjatë një proteste

DOKUMENTI

Tenderët e spitalit, KLSH kallëzon në prokurori dy ish-drejtorët e Durrësit

Në faqen 10

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi, takim në Vorë: Mos hapja e negociatave, pasoja kritike për vendin

Në faqen 5

MOSPAGIMI I TAKSAVE

Pasuria, prokurorja Donika Prela në veting, përplasje me amerikanin e ONM

Në faqen 9

"VIP PAGES"

Nudo artistike apo provokuese, VIP-at që guxuan të heqin rroba

Suplement

META: I UROJ SUKSESE



Edi Rama betohet edhe si ministër i Jashtëm, opozita: Protestë me 16 shkurt

Në faqen 5

Traditë e bashkëpunimit të teorisë me realitetin në terren, me studentët e vitit të tretë

"Luarasi", praktikë në Gjykatën e Krimeve të Rënda

Pedagogu dhe avokati i njohur, Saimir Vishaj: Përgatitet brezi i ri

NGA VOLTIZA DURO

Universiteti "Luarasi" vazhdon traditën e kombinimit të teorisë me praktikën, me synim përgatitjen e profesionistëve liderë në tregun e punës. Këtë të martë, nën udhëheqjen e pedagogut dhe avokatit të njohur Saimir Vishaj, studentët e vitit të tretë në Fakultetin e Drejtësisë kanë qënë të pranishëm në ambientet e Gjykatës së Krimeve të Rënda. Të rinjtë janë organizuar në grupe dhe kanë vënë në jetë 3 gjyqe simuluese, duke marrë rolin e gjykatësve, prokurorëve ...
Në faqen 8



KONCENSIONET VENDIMI

Shkarkohet kreu i ARRSH, Afrim Qendro, zëvendësohet nga Sonila Qato

Furtunë tek Infrastruktura, shkarkohen drejtorët e Gjìknurit

Ikin drejtori i Portit të Durrësit dhe kreu i Operatorit të Transmetimit

Kreu i Autoritetit Rrugor Shqiptar, drejtori i Autoritetit Portual Durrës dhe kreu i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë janë larguar brenda 48 orëve nga detyra. Vendimi për shkarkimin e kreuve të ARRSH-së dhe kreuve të Portit të Durrësit janë firmosur nga ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku. Ndërsa kreu i OST-së ka dhënë dorëheqjen. Burime me Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bëjnë me dije se drejtorët e ish-ministrit Damian Gjìknuri janë shkarkuar me firmë të ministres Balluku. Të njëjtat burime bëjnë me dije se ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ka emëruar drejtor të Autoritetit Portual Durrës Genti Taren. Gjatë ditës së djeshme është firmosur edhe shkarkimi i kreuve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, Afrim Qendro. Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se në vend të Qendros do të jetë ish-ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato. Ish-drejtori Qendro ka qenë një nga emrat e përfolur kohët e fundit, pas shpërthimit të skandalit me "DH Albania".



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

SHKARKIMET

- Drejtori i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Afrim Qendro.
- Drejtori i Portit të Durrësit, Afrim Bakaj.
- Drejtori i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Klodian Gradeci.



Kryeministri Edi Rama dhe ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku gjatë inspektimit të punimeve në rrugën Tiranë-Elbasan

Hapet në maj rruga Tiranë-Elbasan, Rama e Balluku inspektojnë punimet

Rruga Tiranë-Elbasan pritet të bëhet e aksesueshme për përdoruesit në maj të këtij viti. Ndërsa ka inspektuar punimet që po kryhen në këtë aks rrugor, kryeministri Edi Rama ka shprehur kërkesën që rruga të përfundojnë plotësisht në muajin maj. Ndërkohë, rruga pritet të bëhet fillimisht e aksesueshme për trafikun në karexhatën e majtë nga data 15 mars. "Rëndësi ka që tani nuk ka më problem teknik. Në mars është mirë të hapet njëra anë dhe në maj të mbarojë e gjitha", është shprehur kryeministri, teksa e ka cilësuar këtë segment rrugor një 'gangrenë'. E pranishme në inspektimin e punimeve ishte edhe ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.



mpanisë "DH Albania", një tender me vlerë 11 milionë euro (1 miliardë dhe 447 milionë lekë). Bëhet fjalë për ndërtimin e linjës 220 kilovolt Burrel-Peshkopi dhe traktin dalës të nënstacionit të Burrelit, një nga tender-

at më të mëdhenj të zhvilluar nga OST gjatë këtij viti. Sipas dokumenteve të siguruar nga Agjencia e Prokurimeve Publike, tenderi është zhvilluar në nëntor dhe "Dunwell Haberman Albania" e ka fituar atë me

100 për qind të vlerës limit. Më konkretisht, sipas dokumenteve të APP-së, fondi limit për ndërtimin e linjës Burrel-Peshkopi ishte përcaktuar 1 miliardë dhe 447 milionë lekë dhe po me këtë çmim është fituar nga "DH Albania".

Tatimet, procedura e re për mbledhjen e borxheve dhe urdhri për bllokimin e llogarive

Administrata Tatimore bën të ditur procedurën për të mbledhur me forcë detyrimet tatimore të papaguara, kur konstaton se tatimpaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij. Administrata tatimore verifikon nëse tatimpaguesi ka apeluar detyrimin tatimor në hallkën përkatëse të apelimit tatimor. Administrata tatimore dërgon në adresë të tatimpaguesit njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore, nëse detyrimi tatimor nuk është apeluar ose është humbur e drejta e apelimit dhe e njofton atë për fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore. Nëse tatimpaguesi ka paraqitur në Drejtorinë e Apelitit Tatimor ose në Komisionin për Shqyrtimin e Apelitit



Tatimor një ankim, procedurat e mbledhjes me forcë fillojnë me mbarimin e procedurave të ankimit. Procedurat e ankimit konsiderohen se kanë përfunduar ditën e parë të mbarimit të afatit

ligjor që ka tatimpaguesi për t'iu drejtuar gjykatës. Për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore, Administrata Tatimore në çdo rast merr në konsideratë analizimin dhe vlerësimin e riskut, çka do

PROCEDURAT

Administrata tatimore dërgon në adresë të tatimpaguesit njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore, nëse detyrimi tatimor nuk është apeluar ose është humbur e drejta e apelimit dhe e njofton atë për fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore

me të tjera të dërgimit të njoftimit, përveç postës, duke përfshirë edhe dorëzimin dorazi të njoftimit kundrejt konfirmimit të marrjes së tij prej tatimpaguesit. Me kalimin e 10 ditëve nga data e nisjes me postë të këtij njoftimi ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit të njoftimit tek tatimpaguesi, fillon zbatimin e procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore. Në çdo rast, shuma që kërkohet të bllokohet nga bankat është shuma më e vogël ndërmjet shumës që administrata tatimore kërkon të marrë me shumën që rezulton në llogarinë bankare të tatimpaguesit në momentin e nxjerrjes së "Urdhër bllokimit".



Tabaku: Nisma për PPP-të fasadë, financat publike në rrezik

Partia Demokratike e ka konsideruar nismën për ndalimin e PPP-ve si fasadë dhe një përpjekje të qeverisë për të justifikuar para ndërkombëtarëve të gjithë propozimet e madhe të borxhit që kanë hapur në ekonominë shqiptare. Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku përmes një statusi në rrjetet sociale ka bërë të ditur se qeveria e vendosur nën presionin e opozitës, por edhe në paralajmërimet e vazhdueshme të ndërkombëtarëve ka vendosur më së fundi që të ndalojë dhënien e mëtejshme të koncesioneve të kësaj natyre, ndërsa ka shpërndarë deri më tani miliardë euro punë dhe kontrata



nëpërmjet skemës së PPP-ve. Më tej, ajo vinte theksin te kontrata korruptive që qeveria lidhi në kurriz të shqiptarëve nëpërmjet PPP-ve. "Ky ndryshim ligjor vjen mbasi kanë koncesionuar çdo aks rrugor me programin e 1 mld, që tashmë

ka shkuar 2,2 mld e mbasi kanë vendosur financat publike në rrezik me rritjen e borxhit me 12 për qind vetëm nga këto kontrata. Të gjitha ato janë abuzive, të pabazuara në studime, korruptive e me kosto të fryra dhe do të analizohen një për një

duke çuar para drejtësisë këdo që ka abuzuar me fondet publike", - nënvizoi Tabaku. "Ndaj - tha ajo - këto ndryshime ligjore janë fasadë dhe nuk kanë gjasa të zbatohen nga një qeveri që është vendosur në qendër të disa skandalëve me PPP". Sipas saj, nëse qeveria është kaq e vendosur kundër PPP duhet të kishte vendosur që asnjë kompani me letra "offshore" nuk mund të fitojë një të tillë koncesion. Tabaku shprehet se platforma antikorrupsion që ka hartuar PD do të çlirojë ekonominë nga kjo barrë e rëndë dhe buxhetin e shtetit nga kostot e qokave në formë PPP-je.

Ekzekutivi ka paraqitur në Kuvend nismën që ndalon propozimet e pakërkuara

Qeveria ndalon koncesionet për rrugët, nga 1 korriku s'ka më PPP

Do lejohen vetëm PPP për porte, aeroporte dhe energji

Qeveria ka vendosur që të heqë dorë nga kontratat e Partneritetit Publik-Privat të njohura ndryshe si PPP-të. Nga 1 korriku i këtij viti nuk do të pranohet asnjë propozim i pakërkuar për kontrata koncesionare nga subjektet private, përveç atyre që kanë të bëjnë me disa fusha specifike, si ndërtimi i aeroporteve apo i porteve. Kështu, një projektligj i dërguar në parlament paralajmëron heqjen e mundësisë ligjore për "koncesione të pakërkuara" nga 1 korriku 2019, duke anuluar në këtë mënyrë mekanizmin ligjor më kontrovers të përdorur nga vetë qeveria përgjatë viteve të fundit. Projektligji që vjen me iniciativë nga Ministria e Financave thotë se qeveria nuk do të ketë më të drejtë ligjore të pranojë "propozime të pakërkuara" për koncesione të llojit të atyre, që aktualisht i mundësuan të njëjtës qeveri të nënshkruajë mbi 1 miliard euro kontrata, ndërsa relacioni shoqërues shpjegon se ndryshimi ka ardhur si pasojë e "rekondimeve" nga institucionet ndërkombëtare, të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. "Ky projektligj përcakton shprehimisht që pas datës 1 korrik 2019 nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni/PPP, në formën e propozimit të pakërkuar për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë", shkruhet në relacionin e publikuar në faqen në internet të Kuvendit të Shqipërisë. "Referuar rekondimeve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si FMN, Banka Botërore, SIGMA-OECD dhe duke marrë shkas se tendenca e shteteve ndërkombëtare gjatë viteve



ARGUMENTI

"Referuar rekondimeve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si FMN, Banka Botërore, SIGMA-OECD dhe duke marrë shkas se tendenca e shteteve ndërkombëtare gjatë viteve të fundit është ajo e reduktimit të propozimeve të pakërkuara, kemi propozuar kufizimin e propozimeve të pakërkuara nga sektori privat".

të fundit është ajo e reduktimit të propozimeve të pakërkuara kemi propozuar kufizimin e së drejtës së identifikimit të zhvillimit të propozimeve të projekteve të koncesionit/PPP, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara nga sektori privat", - thuhet në relacion. "Me anë të këtij projektligji është propozuar që nga data 1 korrik 2019 të

lejohen propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror", - vijon më tej argumentimi i Ministrisë së Financave. Qeveria aktuale është kritikuar në Shqipëri

PROJEKTILIGJI

- Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.
- Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e koncesionit/Partneritetit Publik Privat. Nuk do të pranohen propozimet e pakërkuara, të shoqëruara me studim në formë minimale.
- Kur procedura e dhënies së koncesionit/ Partneritetit Publik Privat e nisur mbi një propozim të pakërkuar finalizohet me nënshkrimin e kontratës, autoriteti kontraktues kompenson shpenzimet e bëra nga propozuesi për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, vetëm nëse propozuesi i pakërkuar nuk është ofertuesi fitues.
- Shuma e kompensimit për propozimin e pakërkuar nuk mund të jetë më e lartë se 1% e vlerësimit. Vlera e përcaktuar e kompensimit do të publikohet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe do të paguhet nga ofertuesi i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës.
- Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkuara dhe mënyrën e llogaritjes së shumës së kompensimit.

dhe jashtë saj për një mori kontratash koncesionare me vlera të konsiderueshme, të cilat janë realizuar ose me ligje të veçanta që shmangin konkurrencën dhe përcaktojnë paraprakisht fituesin, ose përmes "propozimeve të pakërkuara", të cilat në praktikë eliminonin konkurrencën dhe përcaktojnë me vendim qeverie një avantazh

të pathyeshëm për propozuesin, duke e bërë garën pa-suesë thjeshtë formalitet. Institucione të ndryshme, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar, Departamentin e Shtetit të SHBA apo Komisionin Europian kanë ngritur pikëpyetje të mëdha mbi format ekstraligjore të ndjekura nga qeveria aktuale për negociimin e kontrat-

ave koncesionare në kurriz të taksapaguesve. Kështu, sipas FMN, "kuadri i punës së qeverisë për përzgjedhjen dhe priorizimin e projekteve të investimit, si dhe për vlerësimin e kostove dhe rreziqeve fiskale, mbetet i pamjaftueshëm" dhe fondi pati kërkuar në fillim të vitit 2018 ndalimin e dhënies së koncesioneve të reja. Sipas Departamentit të Shtetit, "përdorimi në rritje i kontratave të partneriteteve publike dhe private ka ngushtuar mundësitë për konkurrencë, përfshirë nga infrastrukturë e huaj, në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë". Komisioni Europian detyroi qeverinë shtatorin e kaluar të heqë dorë nga ligji fillestar, që parashikonte negociim privat me kompaninë "Fusha" sh.p.k për ndërtimin e një teatri kombëtar në shkëmbim të zhvillimit të një pjesë të tokës publike të zënë nga ndërtesat ekzistuese të teatrit, për shkak se ligji sillte kufizim të konkurrencës. Qeveria njoftoi të hënën më 21 janar tërheqjen nga faza e negociimit për kontratën më të madhe koncesionare të saj, atë për segmentin rrugor Thumanë-Kashar, me distancë 21 kilometra dhe me kosto të përgjithshme prej 435 milionë eurosh, pa dhënë shpjegime për shkaqet që sollën anulimin.

PROTESTA VENDIMI

Vendimi, një grup pune që do të funksionojë për përgatitjen e alternativës së re

PD paralajmëron protestë masive më 16 shkurt kundër qeverisë

Protesta edhe në disa prej qyteteve kryesore

Valentina Madani

Partia Demokratike vendosi dje të zhvillojë një protestë masive në datën 16 shkurt, në orën 11:00 kundër qeverisë "Rama". Protesta e madhe do të paraprihet nga protesta të tjera në disa prej qyteteve kryesore në vend. Kreu demokrat, Lulzim Basha, gjatë gjithë ditës së djeshme zhvilloi takime me strukturat e partisë dhe vetëm në mbrëmje u ra dakord për datën e zhvillimit të protestës. Mësohet se gjatë mbledhjes së Kolegjit të Kryetarëve dhe më pas kryesisë së PD-së, kreu Lulzim Basha ka urdhëruar përgatitjen e strukturave të partisë në mbarë vendin për të mblodhur sa më shumë njerëz me datën 16 shkurt. Gjatë ditës së djeshme Kolegji i Kryetarëve dhe anëtarët e rinj të kryesisë diskutuan në lidhje me qasjen e re të demokratëve ndaj bazës për të frymëzuar dhe krijuar besim në alternativën e opozitës. Pavarësisht diskutimeve të gjata në lidhje me thirrjen e protestave, kryesia vendosi pikërisht 16 shkurtin si ditën e fillimit të protestave masive, të cilat sipas demokratëve nuk do të ndalin deri në rrëzimin e qeverisë "Rama". Por gjatë këtyre mbledhjeve mësohet se është diskutuar edhe në lidhje me data të mundshme të organizimit të protestave në mbarë vendin. Për simbolikën që përmban si datë, disa nga anëtarët e kryesisë kanë propozuar një datë afër 20 shkurtit, ditës së rrëzimit të bustit të diktatorit Enver Hoxha në vitin 1991, për zhvillimin e protestës së parë popullore. Kolegji i Kryetarëve, i cili përbëhet nga të gjithë kryetarët e degëve të PD-së dhe është krijuar si një strukturë ndihmëse dhe këshillimore e kreu të PD-së garantoi z.Basha për një protestë masive. Basha u ka kërkuar përfaqësuesve të tij politikë që të intensifikojnë takimet dhe kontaktet me bazën. Sipas Bashës, ekipi i ri i zgjedhur duhet të japë shprehje dhe të sigurojë opti-



Mbledhja e djeshme e kryesisë së PD-së

UDHËZIMI
Z. Basha gjatë gjithë ditës së djeshme zhvilloi takime me strukturat e partisë dhe vetëm në mbrëmje u ra dakord për datën e zhvillimit të protestës. Mësohet se gjatë mbledhjes së Kolegjit të Kryetarëve dhe më pas Kryesisë së PD-së, Basha ka urdhëruar përgatitjen e strukturave të partisë në mbarë vendin për të mblodhur sa më shumë njerëz në 16 shkurt.

Projektligji, lehtësohet procedura për pajisjen me pasaportë

Të gjithë ata shtetas që u ka skadur apo janë në prag të skadimit të kartës apo pasaportës biometrike nuk do duhet më që të paraqiten në komisariatet e policisë për të marrë vërtetimin për të rinovuar dokumentet e tyre të identifikimit. Tashmë ato do duhet vetëm të marrin kuponin e pagesës në postë dhe të paraqiten me një fotografi në zyrën e ALEAT, pranë njësisë vendore për të aplikuar për dokumentin e ri të identifikimit. Ministria e Brendshme ka paraqitur në Kuvend disa ndryshime ligjore që ofrojnë lehtësira për pajisjen me pasaportë të të gjithë qytetarëve që janë pajisur një herë më parë me pasaportë ose kartë identiteti. Këto propozime janë të nevojshme, pasi në vitin 2019 mbushen 10 vjet nga data e fillimit të pro-



dhimit dhe pajisjes së shtetasve shqiptarë me pasaporta biometrike dhe për rrjedhojë, parashikohet të ketë një fluks të madh aplikimesh nga shtetasit shqiptarë që do të ripajisjen me pasaporta. Ndryshimi i propozuar elimonon paraqitjen pranë komisariatëve të policisë të të gjithë shtetasve, të cilët janë verifikuar një

herë nga policia, kur kanë aplikuar për pasaportë biometrike për herë të parë. Gjatë procedurës së aplikimit për t'u ripajisur me pasaportë, shtetasi do të paraqesë pasaportën e mëparshme (ose vërtetimin nga Komisarati i Policisë në rast humbjeje të saj), kuponin për pagesën dhe aplikimin (me fotografinë aktuale), në mjediset e përcaktuara nga koncesionari për këtë qëllim, në përputhje me rregullat e miratuara në kontratën koncesionare, midis Ministrisë së Brendshme dhe koncesionarit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projektligji është propozuar mundësia e ripajisjes së shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike edhe 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës së mëparshme.

mizëm se shumë shpejt demokratët do të vijnë në pushtet përmes votës dhe falë programit të tyre politik. Një grup pune që do të funksionojë pranë kryetarit të PD-së do të koordinojë punët edhe për përgatitjen e alternativës së re, me të cilën demokratët do të paraqiten

përpara shqiptarëve. Këshilli ngarkoi strukturat drejtuese të PD-së që të merrnin me organizimin e protestave në mbarë vendin, me qëllim rrëzimin e qeverisë dhe të Edi Ramës. Gjithashtu, këshilli mori vendim politik që si zgjidhje politike pas rrëzimit të qeverisë "Rama", një

qeveri tranzitore, kalimtare të merrtet me organizimin e zgjedhjeve të lira. Kreu i PD-së, Lulzim Basha ka bërë të qartë se rruga e vetme për rrëzimin e Edi Ramës nga pushteti janë protestat mbarë popullore, të cilat nuk do të ndalin deri në rrëzimin e qeverisë.



Kryeministri Edi Rama gjatë ceremonisë së betimit dje në Presidencë

Spiropali emërohet zëdhënëse e qeverisë: Opozita, akt të ulët politik

Ministria e Shtetit për Parlamentin, Elisa Spiropali ka marrë dje zyrtarisht edhe një detyrë tjetër, atë të zëdhënësës së qeverisë, ndërsa ka zhvilluar në Kryeministri një komunikim të parë me gazetarët lidhur me çështjen e anulimit të koncesionit Thumanë-Kashar. Ajo i quajti qesharake deklaratat e opozitës se nuk kishte buxhet për këtë rrugë dhe se qeveria mashtrroi studentët kur tha se financimet do kalonin për ta. Spiropali theksoi se bëhet fjalë për një kontratë koncesionare dhe ku paratë në fazën e parë do të paguheshin nga privati dhe jo nga shteti. "Keqardhje për këtë akt të ulët të politikës. Rrugë e Arbrit figuronte si rrugë që nuk ka buxhet, ndërkohë deri sot Rrugë e Arbrit është ndërtuar me fonde të kompanisë, këtë vit nis të kontribuojë qeveria. Ky është mekanizmi i PPP, ndaj PPP-të nuk janë krime. Procedura Thumanë-Kashar ishte në fazën finale dhe do niste puna e subjektit privat", - sqaroi Spiropali. Sipas saj, procedura Thumanë-Kashar është anuluar dhe hapësira fiskale e qeverisë për këtë kontratë do i kalojë kampusit universitar dhe të gjitha projekteve infrastrukturore që do burojnë nga Pakti për Universitetin.



Anulimi i PPP Thumanë-Kashar, LSI: 0 lekë do shkojnë për studentët

Deputetja e LSI-së, Kejdi Mehmetaj, në një dalje për mediat ka përgënjësuar deklaratat e ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali. Sipas deputetes së LSI-së, Spiropali po gënjën studentët për lekët e përfutur nga anulimi i PPP Thumanë-Kashar dhe se zero lekë do t'u jepen atyre për realizimin e kërkesave. "Kryeministri po e vërton që është bërë me hije nga protesta e studenteve. Mirë që është bërë me hije. Tani nuk u vëmë faj as ministrave të rinj që i shkojnë pas avazit. Rama nxori sot një ministër për të mashtruar për protestën e studenteve. Kjo është tabela e buxhetit të shtetit e votuar dy herë nga mazhoranca në parlament, ku thuhet se 0 lekë do t'u jepen studenteve për realizimin e kërkesave të tyre. Ministria e re në vend që të japë shpjegime të çuditshme për aksin Thumanë-Kashar. Kjo shihet qartazi në koncesionet e rrugëve. Mos u gënjoni nga asnjë deklaratë të ministrit të kryeministrit", u shpreh ajo.



Valentina Madani

Edi Rama u betua dje para Presidentit të Republikës, Ilir Meta, si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ceremonia e shkurtër e betimit u bë mbrëmë menjëherë sapo kreu i shtetit, Meta, mbërriti në Tiranë nga një vizitë dyditore në Malin e Zi, ndërkohë që kryeministri Rama ndërpreu një takim me studentët e Universitetit "Aleksandër Xhuvani". Edi Rama mbërriti në Presidencë i shoqëruar nga kreu i deputetëve të PS-së, Taulant Balla, ndërkohë që ceremonia e betimit zgjati shumë pak. "Pas ekzekutimit të himnit kombëtar dhe leximit të dekretit përkatës, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, njëkohësisht kryeministër, Sh. T. Z. Edi Rama, u betua, duke vendosur dorën mbi Kushtetutën e Shqipërisë. Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta, duke i dorëzuar dekretin, i uroi suksese në këtë detyrë shumë të rëndësishme. Në ceremoni ishte i pranishëm kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla dhe anëtarë të kabinetit të Presidentit të Republikës", njoftoi zyra e shtypit pranë Presidencës. Rama betohet si ministër një ditë pasi Kuvendi miratoi dekretin e Presidentit Ilir Meta për shkarkimin e Ditmir Bushatit në krye të MEPJ dhe emërimin e Ramës edhe në postin e ministrit. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati është shkarkuar dje nga Kuvendi me 77 vota pro dhe 1 abstencion. Vota abstenim ka qenë nga deputeti Spartak Braho, ndërsa vetë ministri ka votuar pro shkarkimit të tij. Sakaq, kryeministri Edi Rama është emëruar si ministër i Jashtëm me 78 vota pro. Kujtojmë se kryeministri Edi Rama vendosi të marrë vetë edhe postin e ministrit të Jashtëm pas refuzimit që i bëri Presidenti Ilir Meta kandidatit të Gent Cakajt me pretendimin se nuk plotësonin kriteret dhe nuk ishte pajisur me certifikatë sigurie. Kjo çështje shkaktoi përplasje mes Presidencës dhe Kryeministrit, ndërsa Rama ka thënë se mazhoranca ka padisë Presidentin Meta për shkelje të Kushtetutës sapo ky organ të formohet.

TAKIMI

Më herët, kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me studentët të Universitetit të "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, të cilëve u tha se i duhet të largohet pasi ka për të bërë betimin. Rama i la studentët me ministrin e re të Arsimit, Besa Shahinin, për të vijuar diskutimin. "Tani

Kryeministri, studentëve: Unë duhet të iki se kam për të bërë një betim

Rama betohet mbi Kushtetutë si ministër i Jashtëm, Meta: Suksese!

Soreca: Rama do ta çojë përpara agjendën e Shqipërisë



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

CEREMONIA

Ceremonia e shkurtër e betimit të Ramës si ministër i Jashtëm u bë mbrëmë menjëherë sapo kreu i shtetit, Meta mbërriti në Tiranë nga një vizitë dyditore në Malin e Zi, ndërkohë që kryeministri ndërpreu një takim me studentët e Universitetit "Aleksandër Xhuvani".



Kryemadhi: Me Ramën kryeministër rrezikojmë hapjen e negociatave

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, gjatë një takimi dje me strukturat e LSI-së në Vorë deklaroi se hapja e negociatave është jetike për vendin. Sipas saj, hapja e negociatave do të sillte zhvillim, ndërsa moshapja e tyre izolim për vendin. Gjithashtu, Kryemadhi shtoi se me Ramën kryeministër e ardhmja drejt integrimit Europian është shumë e largët. "Hapja e negociatave do të sillte një zhvillim për Shqipërinë, do të sillte investime për vendin. Moshapja e negociatave është vrastare për vendin. Hapjen e negociatave nuk e ka marrë peng edhe Shqipërinë. Sot kemi vetëm të rinj dhe të reja që po largohen nga Shqipëria. Janë 26 premtime dhe asnjë premtim nuk është mbajtur. Rama mbajti vetëm një premtim, tha se do të bënte korridorin e 'Syrit të Kaltër', bëri korridorin e drogës", tha zj. Kryemadhi.

"Muajt në vijim, të rëndësishëm për Shqipërinë"

BE: Mos e merrni të mirëqenë vendimin e qershorit. Do ishte gabim

Ambasadori i BE-së, Luigi Soreca i kërkoi dje politikës shqiptare me shumë përpjekje për konsensus me fokus integrimin e vendit. Ambasadori u shpreh se do të ishte gabim, nëse Shqipëria nuk do të fokusohet këtu muaj. "BE ka mirëpritur shumë këto zhvillime të fundit, por duhet bërë më shumë. Koha është thelbësore dhe vendimi i qershorit nuk duhet të merret i mirëqenë. Nuk ka mbetur shumë kohë deri në etapën e ndryshme të pranverës. Do të ishte një gabim për Shqipërinë që të mos fokusohet një të bërë gjithçka që mund të bëjë vendi gjatë muajve të ardhshëm për t'u paraqitur plotësisht i përgatitur", deklaroi z. Soreca. Ambasadori i BE-së, Luigi Soreca përsëriti mesazhin që vendet e BE-së i përcjellin qeverisë për rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. "Ajo që shtetet anëtare presin nga Shqipëria u tha qartë qershor-



KLAJDA GJOSHA

"Qershor është jetë a vdekje për një proces jetik, siç është procesi i integritimit europian. LSI është e gatshme të bëjë çdo sakrificë për të çuar përpara këtë aspiratë të çdo qytetari shqiptar. Sfidat që kemi para kërkojnë përgjegjshmëri të lartë politike", tha deputetja e LSI.

in e kaluar: Të konsolidojë progresin në përparësitë kyçe dhe veçanërisht të japë rezultate të prekshme dhe konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", deklaroi ambasadori Soreca. Në ceremoninë e hapjes së Presidencës ru-munet të Këshillit të Bashkimit Evropian, e cila u mbajt në Shtëpinë e Evropës në Tiranë, ambasadori nënvizoi se reforma në drejtësi bazuar në veting-u funksionon dhe është e pakthyeshme, por se duhet të ketë historik i vazhdueshëm ndjekjes penale dhe dënime përfundimtare.

"Ka pasur operacione shumë inkurajuese të zbatimit të ligjit gjatë muajve të fundit, të cilat jo vetëm që duhet të vazhdojnë, por edhe të ndiqen nga një historik i vazhdueshëm ndjekjes penale dhe dënime përfundimtare. Po ashtu, kohët e fundit kemi parë progres shumë të rëndësishëm lidhur me reformën në drejtësi, me piktetën e ngritjes së institucioneve të reja, kjo shtron udhën për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë si dhe përngritjen e SPAK dhe BKH", tha Soreca.

më lejoni të bëjmë një pakt, ju mos lëvizni fare, bëni sikur s'po ndodh asgjë, unë po largohem tani sepse kam një

më kanë pëlqyer protestat ballë për ballë, kështu që me të mund të ngujoheni deri nesër dhe vazhdoni bisedën", u shpreh ambasadori Soreca.

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARË - për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke NGB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna: Nr. 1/387-N1, ZK. 8562, VOL. 30, FAQ. 91 e ligjit nr. 109 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babari", Korçë në pronësi të Pandëll Boriç. Në vlerën 49.740 EUR! (gjatëditjet e nentë mijë e shtatëdhjetë e gjashtëdhjetë) EUR Nr. 1/387-N3, ZK. 8562, VOL. 30, FAQ. 93 e ligjit nr. 109 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babari", Korçë në pronësi të Pandëll Boriç. Cmimi më i ulët fillon ankandën është në vlerën 57.088 EUR! (pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tetë) EUR. Ankandë zhvillohet në datën 04.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartës gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

NJOFTIM
Në datë **05.02.2019 në orën 16.00** në zyrën e përmbartës gjyqësor privat Irina Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhë, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandë për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Trruall+Ndertesë" me sip. Trruall 220 m2 dhe sip.ndertesë 97 m2, me nr.pasurie 11/23, volumn 10, faqe 229, zone kadastrale 8503, ndodhur në Lagjia "Jani Vruho", Berat.Cmimi në ankand të dyte është në vlerën **2,296,000** (dy milion e dyqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Përmbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartës gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoça, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 22.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandë liri në përshiten e pasurisë së paluajtshme, Arë, me sipërfaqe 13.000 m², Nr.pasurie 89/10 Zona Kadastrale Nr. 1669, Vol. 5, Fa. 202, në pronësi të Z. Sahar Ibrahim, Flamur Ibrahim, Arben Ibrahim, Eduard Ibrahim, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë filluese në ankand 98.280 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme, Arë, me sipërfaqe 8.200 m², Nr.pasurie 6/4, Zona Kadastrale Nr. 1669, Vol. 4, Fa. 34, në pronësi të Z. Fahir Kaziu, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë filluese në ankand 115.920 (Njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 221 3188. email enuar.merko@gmail.com

Presidenti me politikanët shqiptarë në Tuz: Bashkëpunoni që të fitoni komunën

Valentina Madani

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta apeloj dje për një përfaqësim më përfshirës dhe më të drejtë të shqiptarëve në institucionet qendrore dhe lokale të Malit të Zi. Z. Meta u prit në një takim nga kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, në vijim të vizitës së tij shtetërore në Mal të Zi. Gjatë takimit, Presidenti Meta shprehu dëshirën që bashkëpunimi i mirë që ekziston midis dy vendeve të përshpejtohet dhe të thellohet më tej në të gjitha fushat, duke pasur si objektiv parësor ndërlidhjen gjithnjë e më të mirë mes qytetarëve në të dyja anët e kufirit. Kreu i shtetit inkurajoi përcaktimin e prioritetëve të qarta dhe ndjekjen e projekteve konkrete në fushën e infrastrukturës, mjedisit, ujërave, turizmit etj., që i japin përmbajtje dhe shprehin vullnetin e ndërsjellë politik për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Presidenti Meta theksoi se partneriteti në NATO duhet të frymëzojë marrëdhënie më të ngushta dhe të afërta ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe se të dyja qeveritë i kanë të gjitha mundësitë ta modelojnë këtë bashkëpunim në përcim të vlerave më të mira të Aleancës. Gjithashtu, Presidenti Meta apeloj për një përfaqësim më përfshirës dhe më të drejtë të shqiptarëve në institucionet qendrore dhe

Meta-Markoviq: Shqiptarët e Malit të Zi të përfshihen në institucione

"Partneriteti në NATO të frymëzojë dy vendet"



lokale të Malit të Zi. Nga ana e tij, Kryeministri i Malit të Zi e informoi Presidentin Meta për disa projekte konkrete në mbështetje të zonave ku banojnë shqiptarë, siç është ndërtimi i rrugës Tuz-Grabon, rikonstruksioni i shkollës së fshatit Dacaj në Rozhajë, përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Plavë dhe

Guci, hapja e disa pikave kufitare në këtë zonë si edhe në Ulqin, punësimi i shqiptarëve në institucionet qendrore dhe lokale, etj. Presidenti Meta shprehu kënaqësinë që faktori shqiptar në Mal të Zi vazhdon të kontribuojë pozitivisht dhe në mënyrë të qendrueshme në të gjitha proceset demokratizuese dhe zhvillimore, duke qenë faktor kyç për qasjen euro-atlantike dhe europiane të vendit.

TAKIMI
Presidenti Ilir Meta zhvilloi dje edhe një takim me përfaqësuesit kryesorë të partive politike shqiptare në qytetin e Tuzit, ku u bëri thirrje që të përafrojnë qëndrimet në mënyrë që pas zgjedhjeve vendore, shqiptarët të kenë një përfaqësim më përfshirës. Teksa u njoh me zhvillimet më të fundit për përgatitjet e zgjedhjeve që do të mbahen në 3 mars 2019, Meta u shpreh ndër të tjera se këto zgjedhje do t'u ofrojnë partive politike shqiptare mundësi për sigurim të së drejtash. "Ju uroj suksese të gjithë juve që merrni pjesë në këtë garë elektorale, që jo vetëm të kontribuoni për të përmirësuar qeverisjen vendore këtu, por njëkohësisht për të treguar aftësitë drejtuese të shqiptarëve të Tuzit përmes bashkëpunimit, por edhe përmes edhe bashkëjetesës me malazezët dhe me të gjitha grupimet e tjera. Dëshirojmë që të vazhdojmë këto marrëdhënie shembullore të Shqipërisë dhe Malit të Zi edhe që shqiptarët në Malin e Zi të vazhdojnë të jenë faktor kyç për të ardhmen euro-atlantike dhe europiane të Malit të Zi. Ashtu sikurse dëshirojmë që shqiptarët të kenë një përfaqësim edhe më përfshirës në nivel vendor dhe kombëtar këtu në Malin e Zi, pasi ju e meritoni plotësisht dhe këto siguri të kam marrë edhe nga Presidenti Gjokanoviq, edhe nga kryeministri Markoviq dhe kryetari i parlamentit. Unë besoj se ju e keni vetë në dorë fatin tuaj dhe në zgjedhjet e 3 marsit do të keni mundësi të siguroni më mirë të drejtat tuaja", deklaroi z. Meta. Presidenti i Republikës u takua konkretisht me kreun e Aleancës Shqiptare, Nik Gjeloshaj; kreun e Lidhjes Demokratike Shqiptare, Nikollë Camaj dhe kryetarin e Unionit Demokratik Shqiptar-Tuz, Fadil Kajoshaj.

VIZITA

Gjatë vizitës shtetërore në Malin e Zi, Presidenti Meta u ndal në muzeun etnografik shqiptar në Tuz. Emocionet e kësaj vizite Meta i ndau me qytetarët. Ai i shpreh mirënjohje patriotit Shjefën Ivezaj dhe familjes së tij e bashkëpunëtorëve që kanë mbledhur dhe ruajtur këtë pasuri.

MESAZHI

Presidenti Meta vizitoi dje Arkipeshkvinë e Tivarit, ku u prit nga Imzot Rrok Gjonlleshaj. Përmes një postimi në "Facebook", Meta theksoi se në këtë objekt kulti kanë shërbyer kolosë të besimit katolik, si Pjetër Bogdani si dhe përkthyesi i parë i Biblës në gjuhën shqipe, Dom Simon Filipaj.

Berisha publikon foton e rrallë me Ibrahim Rugovën

Ish-Presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova po përkujtohet këto ditë nga miqtë, bashkëpunëtorët, por edhe nga mijëra qytetarë nga Shqipëria dhe Kosova, në 13-vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. Kështu, ish-kryeministri Berisha publikoi dje në rrjetet sociale një foto të rrallë me z. Rugova në një moment pushimi. "Me Presidentin Ibrahim Rugova, çaste pushimi!", shprehet z. Berisha. Edhe dy ditë më parë ish-kryeministri Berisha përkujtoi Ibrahim Rugovën në 13-vjetorin e vdekjes. Berisha shkruan në "Facebook" se ish-presidenti i ndërjerë ishte burrë mendjendritur i kombit tonë. Sipas tij, pas 13 vitësh, argatët e Serbisë në Tiranë dhe në Kosovë po përpichen të zhbëjnë projektin gjeneral, që kishte dhe ëndërronte vazhdimisht Ibrahim Rugova.



Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania ju njofton se duke filluar nga data **30 Janar 2019:**

Paketa ditore standarde do të ndryshojë dhe do të ketë një çmim **150 Lekë** (me TVSH) duke ofruar **150 MB internet**, **150 minuta kombëtare**, si dhe **150 SMS brenda rrjetit Vodafone të vlefshme për 24 orë.**

Dy paketat javore standarde ekzistuese nuk do të ofrohen më në treg.

Një paketë e re javore standarde do të ofrohet në treg e cila do të ketë një çmim **500 Lekë** (me TVSH) dhe do të ofrojë **1GB internet**, **300 minuta kombëtare**, **3.000 SMS brenda rrjetit Vodafone**, si dhe **30 SMS kombëtare e vlefshme për 7 ditë.**

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.



SHKURTE

Komandanti i NATO-s, vizitë në Shqipëri për bazën e Kuçovës

Komandanti i Komandës Ajrore të NATO-s, Gjenerali Tod Wolters, do të vizitojë të enjten vendin tonë. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, vizita vjen në kuadër të fillimit të zbatimit të paketës së NATO-s për bazën ajrore të Kuçovës. Ai do të pritë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku e më pas do të zhvillojë një takim me ministrin e Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka. Pas përfundimit të pritjes me truporë nderi të gjeneral Wolters, mbi Ministrinë e Mbrojtjes do të ketë fluturime të avionëve të NATO-s.

Bashkëpunim rajonal, Bregu takon Zaev e zyrtarë maqedonas

Sekretarja e Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Majlinda Bregu, gjatë një vizite në Shkup është takuar me zyrtarë të lartë qeveritarë. Bregu do të takohet me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev; kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferi e ministrin e Jashtëm, Dimitrov. Gjatë takimit të saj me zyrtarë maqedonas, Bregu dha mesazhin e saj të qartë, ndërsa tha se Shkupi është mbështetja e Këshillit për nismat dhe bashkëpunimin midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

PROTESTA E STUDENTËVE REAGIMET

Bojkot te Juridiku, Filologjiku, Ekonomiku e Arkitektura: Kryeministri është qesharak

Valentina Madani

Ditën e djeshme, kreu i qeverisë Edi Rama ka zhvilluar një takim me studentët e Universitetit 'Aleksandër Xhuvani' në Elbasan ku prezantoi Paktin për Universitetin. Kryeministri në fjalën e tij theksoi se tarifat janë nën kosto dhe shtoi se qeveria nuk e ka detyrim të luajë rolin e nënës apo babait kur flitet për çështjet e arsimit të lartë. Gjithashtu, Rama iu tha studentëve të Elbasanit se tarifat janë përcaktuar nga vetë universitetet, ndërsa qeveria thjesht ka marrë një vendim për të vendosur një tavan në mënyrë që mos të kalohej limitet. "Është e qartë që tarifat sot janë nën kosto. Tarifat i ka vendosur universiteti dhe qeveria vendos tavanin. Një arsim cilësor lidhet edhe me sa paguan. Të jemi të qartë, por duke pasur parasysh jo sa kapacitet ka një familje për të paguar. Qeveria ka për borxh që në parim të mbështesë ata që vijnë nga familje në nevojë. Qeveria nuk ka detyrim të bëjë babain dhe nënën kur vjen puna tek arsimi i lartë. Kushtet nuk janë më optimale dhe ne kemi rënë dakord për të përgjysmuar tarifat për Bachelorin", tha kreu i ekzekutivit. Ndërkohë ky i fundit shtoi se 8 kërkesat e studentëve janë parë me shumë seriozitet nga qeveria, kjo në respekt të rinjve. "Kemi adresuar me

Rama takim me studentët e Elbasanit: Qeveria nuk është nëna e babai juaj "Një arsim cilësor lidhet me aq sa paguan"



Kryeministri Edi Rama me studentët e Elbasanit

shumë seriozitet 8 pikat e studentëve duke thënë qartësisht se si i kuptojmë ne ato pika. Është një përgjegjësi përtej një 3-vjeçari apo 5-vjeçari. Është e kuptueshme që kjo kërkesë është rezultat i një nevojë për më shumë respekt për studentin", u shpreh Rama. Ndërkaq kryeministri nuk ngurroi të thumbonte edhe studentët e gazetarisë duke theksuar se shumë shpejt do të bëhen pjesë e kuzatit. "Janë 100 studentë gazetar-

ie në një vit. Për katër vjet, 400 gazetarë. Ku? Në Elbasan... Në cilin kuzat do shkoni? Do na shkatërrojnë. Do bëhet një kuzat hane e madhe. Si do vijë dita që kuzati të fillojë të marrë formë prej mermeri, ju po e bëni llamarinë komplet."-tha Rama.

QËNDRESA NË ELBASAN

Para fillimit të bashkëbisedimit me kryeministrin, shumë studentë të universitetit "Aleksandër Xhu-

vani" në Elbasan kanë dalë jashtë godinës së konviktit shtetëror (ku do të mbahej takimi) me pankarta në duar. "Ne pa punë, i gjati me dy punë", shkruhej në pankartat e të rinjve. Shumë prej tyre të revoltuar kanë hedhur akuza se salla e takimit po mbushet me të rinj nga FRESH-i. "Unë jam studente në Elbasan dhe jetoj në konviktin shtetëror ku kushtet janë si mos më keq. Na njoftuan se sot (dje) kryeministri jonë, i famsh-

IRONIA ME GAZETARËT

"Janë 100 studentë gazetarie në një vit. Për katër vjet, 400 gazetarë. Ku? Në Elbasan... Në cilin kuzat do shkoni? Do na shkatërrojnë. Do bëhet një kuzat hane e madhe. Si do vijë dita që kuzati të fillojë të marrë formë prej mermeri, ju po e bëni llamarinë komplet."-tha Rama.

mi i të famshmeve Edi Rama do na nderonte me pjesëmarrjen e tij. Ne nuk na lejuan të shkoni aty pasi salla ka një kapacitet prej 50 personash, dhe u mbush me freshista, ndërsa për ne që adresojmë realisht problemet tona, s'ka vende. Pse duhet të mbushet salla me militantë partie? Apo ndoshta për të duartkultitur sukseset e Edit? I them kryeministrin se në krye të qeverisë nuk e mbajnë ata 50 freshista që ka futur në

sallë", tregon studentja e universitetit "Aleksandër Xhuvani".

BOJKOTI NË TIRANË

Protesta e studentëve mesa duket tani është ndarë në dy grupe: ata që ndjekin mësimin rregullisht si dhe studentët që nuk tërhoqën nga bojkoti deri në plotësimin e kërkesave dhe rrezimin e ligjit për arsimin e lartë. Ditën e djeshme, Fakulteti Juridik në Universitetin e Tiranës për të disatën ditë radhazi ka pezulluar mësimin dhe kanë kërkuar plotësimin e kërkesave. Ata kanë vendosur edhe një pankartë të madhe para godinës së fakultetit në të cilën shkruhej: "Rama je qesharak, plotëso 8 kërkesat". Ndërkohë te Ekonomiku, një pjesë e studentëve kanë bojkotuar, ndërsa shumë të tjerë kanë vijuar mësimin normalisht. Sakaq, te Filologjiku bojkoti vijon në masën 100% e pedagogët qëndrojnë krah studentëve deri në plotësimin e kërkesave të parashtruara.

Studentët-pedagogëve: Kemi besim te ju

Sot mbahet Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit të Shkencave të Natyrës

Ditën e sotme, do të mbahet Asambleja e Personelit Akademik të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Ndërkohë, studentët e FSHN u kanë bërë thirrje pedagogëve të mbështesin kërkesat e studentëve: "Të nderuar pedagogë dhe pedagogë! Ne, studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si dhjetëra mijëra studentë anëmbanë Shqipërisë, kemi mbi një muaj që protestojmë dhe bojkotojmë për të drejta bazike dhe për një universitet më të mirë. Sot është një ditë historike në marrëdhëniet pedagogë-studentë.



Disa asamble pedagogësh kanë dalë hapur pro studentëve dhe të tjera priten të solidarizohen me studentët në këto orë dhe ditë", thonë studentët. Këta të fundit theksojnë se kanë besim të madh te pedagogët dhe presin mbështetje maksimale nga ana e tyre. "Do ta

lartësonit figurën e pedagogut nëse sot shprehni qartë dhe me zë të plotë pro kërkesave dhe protestës sonë, si dhe kundër ligjit të arsimit të lartë që po na e pamundëson universitetin.

Ne kemi besim të madh te ju. Mos na zhgënjoni! Mos na tradhtoni!"

Lëvizja për Universitetin u bën thirrje studentëve të FSHN, edhe pas votimit të djeshëm që ishte masivisht pro bojkotit, të bojkotojnë mësimin masivisht, e të jenë në unison me studentët dhe pedagogët e fakulteteve të tjera. Bojkoti sot, që nesër të fitojë fakultetin!", thuhet në njoftim.

Një foshnjë vetëm 4 muajshe ka humbur jetën në pediatri të QSUT "Nënë Tereza"

Burime për "Balkan Web" bëjnë me dije se foshnja vuante nga bronkopneumonia e theksuar. Vetë Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" bëri me dije të se fëmija me inicialet A. A me moshë 4 muaj, që ka humbur jetën pranë shërbimit të Reanimacionit të Pediatric është trajtuar në mënyrë intensive për 10 ditë nga ekipi reanimator, me mjekime bashkëkohore për një nga komplikacionet më të rënda të fruthit, atë të pneumonisë masive bilaterale. Fëmija ishte vetëm 4 muajshe, moshë në të cilën sipas Kalendarit të Vaksinimit nuk aplikohet vaksina e fruthit.



Përveç kësaj, me gjithë moshën e vogël, foshnja ka vuajtur nga infeksione të përsëritura të mushkërive, për të cilat është trajtuar disa herë. Kjo ka bërë që kjo foshnjë të pësojë një nga komplikacionet më të rënda të fruthit, pneumoninë. Sipas QSUT, gjatë 10 ditëve të qëndrimit të Terapinë Intensive të Pediatric, fëmijës i janë bërë të gjitha protokol-

let mjekësore bashkëkohore si dhe është asistuar me frymëmarrje të drejtur, por me gjithë përpjekjet e ekipit reanimator mjekë infermierë, ishte e pamundur që foshnja të mbijetonte. Kujtojmë që vetëm në dy javët e para të janarit, siç bën me dije ISHP-ja, janë regjistruar 15 raste të prekura nga fruthi.

UNIVERSITETI "LUARASI" PRAKTIKA



Studentët e universitetit "Luarasi" gjatë improvizimit të seancave gjyqësore

Pedagogu Saimir Vishaj: Përgatitim juristë profesionistë për tregun e punës

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" vazhdon traditën e kombinimit të teorisë me praktikën, me synim përgatitjen e profesionistëve liderë në tregun e punës. Këtë të martë, nën udhëheqjen e pedagogut dhe avokatit të njohur Saimir Vishaj, studentët e vitit të tretë në Fakultetin e Drejtësisë kanë qenë të pranishëm në ambientet e Gjykatës së Krimeve të Rënda. Të rinjtë janë organizuar në grupe dhe kanë vënë në jetë 3 gjyqe simuluese, duke marrë rolin e gjykatësve, prokurorëve e avokatëve. Njëpër një mundësi të tilla të ofruara nga "Luarasi", studentët kanë zbatuar me përpikmëri dhe aftësi dijet teorike të marra në auditorë. Ata kanë vlerësuar faktet e kanë dhënë vendime të drejta duke zbatuar ligjin. Saimir Vishaj, pedagogu i lëndës "Procedurë Penale" në "Luarasi" tregon se njëpër një gjyqe të improvizuara përgatiten më së miri juristët e brezit të ri. "Universiteti 'Luarasi' vazhdon gërshtimin e teorisë me praktikën. 'Gati 100 stu-

Studentët e universitetit "Luarasi", praktikë në Gjykatën e Krimeve të Rënda

Organizohen 3 gjyqe simuluese, kombinim i teorisë me praktikën



dentë u përballën në të gjitha pozitat procedurale. Ka 10 vite rresht që vazhdon kjo praktikë. Mendoj që të

gjithë studentët sot atë çfarë kanë mësuar në teori, e kanë shpalosur në sallën e gjyqit, ku të gjithë pavarësisht

pozitës procedurale, avokat, gjyqtar, të pandehur treguan një aftësi të madhe profesionale", - tha profesori dhe avokatit i njohur, Saimir Vishaj.

PRAKTIKA

Vetë studentët e Drejtësisë në "Luarasi" shprehën tejet të kënaqur që janë pjesë e praktikave të tilla mësimore. "Praktika do të ngelet gjithmonë leksioni më i mirë për sa i përket kësaj lënde, duke qenë se njohim më nga afër si subjekte, duke u vënë edhe në pozicionet e tyre", - tha një student i "Luarasi". Një tjetër student i Drejtësisë në "Luarasi" theksoi se motivo-

hen çdo ditë nga praktikat bashkëkohore që universiteti ndjek. "Është shumë e rëndësishme dhe shumë frytdhënëse për ne, pasi na ndihmon shumë që të bëhemi gati profesionalisht për profesionin e gjyqtarit apo prokurorit. Shpresoj që në të ardhmen të jemi edhe ne pjesë e Drejtësisë, gjyqtarit dhe prokurorisë. Motivohemi çdo ditë e më shumë në këto praktika që bëjmë nga universiteti 'Luarasi', - u shpreh një student tjetër. Ata e vlerësojnë pafund kontributin dhe dijet e marra në këtë universitet nga stafi. "Besoj që atë që kemi mësuar në tri vite te

'Luarasi' e kemi vënë në praktikë dhe mendoj që do na shërbejë shumë në të ardhmen, pasi ambiciet tona janë që të vazhdojmë shkollën e Magjistraturës ose Avokatinë. Falënderoj profesor Saimir Vishajn që bëri të mundur të marrim pjesë në këtë seancë simuluese gjyqësore dhe universitetin 'Luarasi' për mundësinë që na ka dhënë", - shtoi një tjetër student. Praktika të tilla bashkëkohore dëshmojnë edhe njëherë se 'Luarasi' vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend, duke dhënë maksimumin në përgatitjen e profesionistëve në të ardhmen.


PRAKTIKË 10-VJEÇARE

"Gati 100 studentë u përballën në të gjitha pozitat procedurale. Ka 10 vite rresht që vazhdon kjo praktikë. Mendoj që të gjithë studentët sot atë çfarë kanë mësuar në teori, e kanë shpalosur në sallën e gjyqit, ku të gjithë pavarësisht pozitës procedurale, avokat, gjyqtar, të pandehur treguan një aftësi të madhe profesionale", - tha profesori dhe avokatit i njohur Saimir Vishaj.



"MUNDËSI PËR TË ARDHMEN"

"Besoj që atë që kemi mësuar në tri vite te 'Luarasi', e kemi vënë në praktikë dhe mendoj që do na shërbejë shumë në të ardhmen, pasi ambiciet tona janë që të vazhdojmë shkollën e Magjistraturës ose Avokatinë. Falënderoj profesor Saimir Vishajn që bëri të mundur të marrim pjesë në këtë seancë simuluese gjyqësore dhe universitetin 'Luarasi' për mundësinë që na ka dhënë", - shtoi një tjetër student.



"LUARASI' NA MOTIVON"

"Është shumë e rëndësishme dhe shumë frytdhënëse për ne, pasi na ndihmon shumë që të bëhemi gati profesionalisht për profesionin e gjyqtarit apo prokurorit. Shpresoj që në të ardhmen të jemi edhe ne pjesë e Drejtësisë, gjyqtarit dhe prokurorisë. Motivohemi çdo ditë e më shumë në këto praktika që bëjmë nga universiteti 'Luarasi', - u shpreh një student tjetër.



Novartis Pharma Services Inc. Tirana-Albania, the Representative Office of the multi-national company, NOVARTIS, the worldwide leader in the pharmaceutical industry, wants to hire a **Product Specialist**.

Job Purpose:

To develop, implement and execute marketing mix and tactical plans for a brand or set of brands in the short and long term.

Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Medicine, Pharmacy, Biology, Chemistry or other relevant University education.
- At least 5 years of experience in pharma industry (in marketing, sales or medical)
- In-depth understanding of marketing, preferably of pharma marketing
- Ability to build excellent relationship with all key stakeholders with high customer centric mindset
- Ability to generate new ideas/projects customized to the local pharma market
- Ability to manage multiple projects and priorities in a high-volume, fast-paced environment
- Marketing and negotiating skills
- Good communications skills
- Digital literacy and comfort with technology
- Good command of spoken and written English
- Excellence in implementing planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV as well as a Motivational Letter at the e-mail address: blerta.rambi@novartis.com
Deadline 31 January 2018
We will contact only the selected candidates

KPK: Prokurorja ka probleme me pasurinë. ONM i kërkon llogari edhe për Shullazin

Vetingu, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM "kryqëzon" drejtuesen e Krimeve të Rënda

Belgu Teo Jakobs, Donika Prelës: Bashkëshorti yt nuk ka paguar taksat, më le shije të keqe

TIRANË

Drejtuesja e komanduar e Prokurorisë për Krime të Rënda, Donika Prela, dhe u përball me institucionet e vetingut. Seanca dëgjimore nuk ka qenë e lehtë, pasi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konstatuar se ka probleme me deklarimin e pasurisë dhe kryesisht në të ardhurat e bashkëshortit. Sipas raportit të Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive, Prela kishte probleme me deklarimet e pasurisë, çka u konfirmua edhe nga hetimet e KPK. Komisioni ka kryer një hetim të pavarur në lidhje me pasurinë. Nga hetimi kanë rezultuar se të ardhurat janë deklaruar rregullisht, pagesa për pagën është bërë kesh dhe nuk janë paguar taksat. KPK kishte konstatuar se bashkëshorti i zonjës Prela, Vangjel Prela prej 2003 deri në 2011-ën kishte marrë pagesën nga një kompani ndërtimi cash, duke shmanjur pagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimet. Po sipas KPK-së, Donika Prela ka mosdeklarim të huamarrjes me 1 milion lekë në tetor të 2010-ës. Ndërkohë ka dyshime për huamarrje 25 mijë në vitin 2010, që e ka kthyer në 2014. Gjithashtu ka dyshime për çmimin e blerjes së një toke, të ardhurat e së cilës i ka paguar nga paga si prokurore.



Drejtuesja e komanduar e Prokurorisë për Krime të Rënda, Donika Prela



Donika Prela para KPK-së

SHULLAZI

Nga ONM-ja, gjatë fazës së hetimit i është kërkuar informacion Donika Prelës për hetimin e Emiljano Shullazit dhe Gilmardo Danit për periudhën maj-tetor 2018 si dhe për procesin ndaj një shtetasi të hetuar nga ajo gjatë kohës kur ishte drejtuese e Prokurorisë në Durrës. Ndërkaq, subjekti (Prela) ka paraqitur raport shpjegues, duke u shprehur se gjithçka ka pasur ia ka paraqitur Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK).

PASURIA

Trupa gjyqësore e kryesuar nga Roland Ilia ngriti gjithashtu dyshime lidhur me mosdeklarimin nga subjekti të një huaje në vlerën e 1 milion lekësh. Si problematikë në raport evidentohet edhe një tjetër hua në shumën e 25 mijë eurove, çështje e cila u prek edhe nga vëzhguesi ndërkombëtar. Pikëpyetje të shumta shoqëronin edhe blerjen e një sipërfaqjeje toke prej 1 mijë metrash katrorë në shumën e 350 mijë lekësh, si dhe të dy apartamenteve me çmime shumë më të ulëta se ato të tregut.

Natyrshëm më lind pyetja: Pse bashkëshorti juaj i punësuar në një kompani ndërtimi e ka marrë rrogën cash në një kohë që ai ka pasur llogari bankare? Pyetja është bashkëshorti juaj është viktimë apo bashkëpunëtor në këtë skemë? Ti duhet të shpëlash shijen e keqe që më ka ngehur, çfarë e mbështet këtë shije të keqe është fakti se pavarësisht se bashkëshorti juaj është gjenjver, është i dyshimtë fakti që ju keni akoma kontakt me ish-punëdhënësin e tij", - tha Jakobs. Ndërkaq, prokurorja Prela iu përgjigj Jakobs, duke u shprehur se e ka të qartë pamundësinë e tij për të kuptuar realitetin shqiptar, pasi jeton në një realitet tjetër. E si për të justifikuar këtë, ajo solli në vëmendje të ish-gjyqtarit belg faktin se është edhe institucionet e shtetit e shmangin pagesën e taksave. Dyshimet se bashkëshorti i prokurorisë i nuk ka paguar taksat gjatë marrëdhënies se punës me një kompani private u rielatun në raportin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Por, Prela i rrëzoi këto pretendime dhe këmbënguli në faktin se bashkëshorti i saj është dëmtuar nga veprimet e kompanisë e për këtë arsye ndodhet në proces gjyqësor: Trupa gjyqësore e kryesuar nga Roland Ilia ngriti gjithashtu dyshime lidhur me mosdeklarimin nga subjekti të një huaje në vlerën e 1 milion lekësh. Si

problematicë në raport evidentohet edhe një tjetër hua në shumën e 25 mijë eurove, çështje e cila u prek edhe nga vëzhguesi ndërkombëtar. Pikëpyetje të shumta shoqëronin edhe blerjen e një sipërfaqjeje toke prej 1 mijë metrash katrorë në shumën e 350 mijë lekësh, si dhe të dy apartamenteve me çmime

shumë më të ulëta se ato të tregut. Lidhur me dy shtyllat e tjera të vetingut, figura morale dhe aftësitë profesionale Prela rezultoi pa probleme, edhe pse vëzhguesi i ONM-së kërkoi shpjegime prej saj për sherrin që pati me një grup prej dhjetë prokurorësh të Krimeve të Rënda për dosjen Shullazi.

Në përfundim pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe paraqiti argumentet e saj, Prela kërkoi konfirmimin në detyrë, duke këmbëngulur se pasuria e saj rrjedh nga burime të ligjshme dhe nga puna e ndershme e saj dhe bashkëshortit. Vendimi për Donika Prelën pritet të shpallet me datë 29 janar.

Polici "hermetike", Lleshaj urdhër të klasifikohet komunikata ditore

TIRANË - 5 Janari ka qenë data e fundit që Policia e Shtetit ka bërë publike informacionet e detajuara mbi krimet, arrestimet, ndalimet apo procedimet. Pas kësaj date në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit në vend të informacionit mbi atë çfarë ka ndodhur në 24 orë në çdo komisarjat apo drejtori policie në vend është publikuar një raport ditor i ngjarjeve ku në mënyrë të përmblodhur jepet vetëm numri i personave të arrestuar dhe lloji i veprës penale, pa asnjë specifikim tjetër si iniciata të autorëve, moshat e tyre, ora, vendngjarja, qyteti etj. Burime nga Policia e Shtetit thanë se ndryshimi i publikimit të komunikatës ka ardhur me urdhër të ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj. Me këtë veprim, policia bën një hap prapa duke zhbërë atë që u vendos si standard 5 vite më parë dhe i jep një goditje të fortë të transparencës dhe informimit të publikut, duke dëmtuar kështu edhe punën e medias. Në janar të vitit 2014, ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri lajmëroi se për herë të parë komunikata e policisë do të deklasifikohet dhe gjithçka do të publikohet në uebin e policisë, duke ruajtur identitetin e personave apo dhe ngjarje të tjera në hetim. Publikimi i komunikatës së policisë i shërbeu transparencës për mediat, e cila për çdo ngjarje i referohet dokumentit zyrtar të policisë i publikuar çdo 24 orë online. Ndërsa sot, me këtë urdhër nga policia nuk mund të marrësh asnjë informacion mbi ngjarjet që tronditën rendin dhe sigurinë në vend. Në fillim të këtij viti, policia nuk dha asnjë informacion për grabitjen e argjendarisë në një qendër tregtare në Tiranë dhe as për sulmin me eksploziv të të afërmeve të një gjyqtareje në Qytetin Studenti.

Grabiti në 2015-ën banesën e prindërve të Elton Çiços, arrestohet 30-vjeçari nga Tirana

TIRANË - Një 30-vjeçar ka përfunduar në pranga, pasi dyshohet si bashkëpunëtor në një vjedhjen me armë në vitin 2015 në Tepelenë. Behet fjalë Erigers Mihalasin, i cili u arrestua dhe në Yrshk nga policia e Tiranës në bashkëpunim me blutë e Gjirokastër. Sipas bluve, i riu është një prej autorëve të grabitjes të banesës së prindërve të Elton Çiços, i cili u ekzekutua në vitin 2015. "Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër kishte urdhëruar ndalimin e tij, pasi ka dyshime të arsyeshme se ky shtetas ka marrë pjesë në vjedhjen me armë të banesës së shtetasit N.C. në qytetin e Tepelenës më datë 31.03.2015. Ndalimi i tij u bë për veprat penale "Vjedhja me armë, kryer në bashkëpunim", "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje



e armëve luftarake dhe e municionit", njofton policia", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, burime nga prokuroria kanë sqaruar se shtetasi E. I. ka pasur dijeni të plotë në lidhje me gjendjen e një shume të madhe financiare që ka pasur i dëmtuari Elton Çiça, i cili përveç të tjerash, dispononte shumë pasuri dhe u kishte dhënë hua shumta të konsiderueshme parash atij dhe vjehrrit të tij

ndërtues, shtetasi R. Z. Gjithashtu, prokuroria pohon se ardhja e autorit Robert Rama nga Tirana në Tepelenë pa kurrfarë interesi tjetër financiar; thjesht për të shqëruar shokun e tij E. I., nuk ka asnjë sens dhe nuk është aspak alibi e besueshme. "Shtetasi E. I., siç sqarohet edhe nga deklarimi i të dëmtuarës Antoleta Çiça, u ka dhënë autorëve edhe një kopje të çelësave të tri kateve të banesës, dyert e të cilave janë hapur me këta çelësa. Ervisi është pikërisht personi që i ka montuar dyert dhe dritaret e të tria kateve të banesës së prindërve të Elton Çiços, ku më pas ndodhi edhe grabitja", bën me dije më tej Prokuroria. Sipas hetimeve, pasi vjedhja nuk përfundoi me suksesin e shpresuar nga autorët dhe pasi automjeti i grabitësve ka mbetur në vendngjarje.

REAGIMI I VËZHguesIT Të ONM

Gjatë seancës së djeshme, belgu Teo Jakobs i ka kërkuar llogari prokurorisë se përse bashkëshorti i saj nuk ka paguar taksat për gjatë viteve, kur punonte si inxhinier ndërtimi në një kompani private. "Jam i sigurt që ju keni provuar të pini ilaçe në mëngjes. Kur nuk je i shpejt për të pirë ilaçin, të ngelet një shije e keqe në gojë dhe s'mund ta shijosh mirë kafën. Pas drekës, shija për mirësisht. Duke lexuar dosjen tuaj, unë këtë ndjeja pata. Ende nuk ka ardhur koha e drekës, ndaj ju duhet të më ndihmoni që të shmag dyshimet dhe të më largohet shija e keqe në gojën time.

"Alban Ramohitaj dhe Viola Cikalleshi, veprime të kundraligjshme në mospërbushje të detyrës

Tenderat e spitalit, KLSH kallëzon në prokurori dy ish-drejtorët e Durrësit

"Shkelje me procedurat e prokurimit për shërbimin e lavanterisë"

Shkeljet në procedurën e prokurimit të shërbimit të lavanterisë së spitalit kanë detyruar Kontrollin e Lartë të Shtetit të kryejë një audit e më pas të çojë për ndjekje penale dy ish-drejtorët të spitalit të Durrësit, Alban Ramohitaj dhe Viola Cikalleshi. "Çështjet e gjetura gjatë auditit konsiderohen si veprime me pasojë të rënda për interesat e ligjshme të shtetit dhe të dënueshme sipas Kodit Penal", thuhet në kallëzimin që është dorëzuar në prokurori dhe që mban firmën e kryetarit të KLSH-së, Bujar Leskaj. Më poshtë publikohet me shkurtime, dokumenti i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KALLEZIMI PENAL

"KLSH në subjektin spitali rajonal Durrës deri më datën 27.11.2018 realizoi auditimin 'Mbi vazhdimin, plotësimin dhe finalizimin e procesit të verifikimit për ankesën drejtuar KLSH-së. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt 'Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për spitalin rajonal Durrës', rezultoi se:

1. Z. Alban Ramohitaj me detyrë, ish-drejtor në spitalin rajonal, Durrës, gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, gjë që ka sjellë direkt ose indirekt, përveç të tjerash, përfitime nga persona të ndryshëm, e konkretisht:

Me shkresën nr. 502/7 prot., datë 28.04.2017, nga titullari z. Alban Ramohitaj është nxjerrë urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, me përbërje Endrit Shehu, kryetar me profesion mjek/n.drejtor teknik; Ermioni Dabaj, anëtarë, me profesion kryeinfermiere; Andi Xhelilaj, anëtar, me profesion jurist/specialist në sektorin juridik; Irena Varaku, anëtarë, me profesion ekonomiste/përgjegjëse e sektorit të financës; Hasime Myftari, anëtarë, me profesion ekonomiste/përgjegjëse e sektorit të hotelarisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe takimeve të bëra, konstatohet se asnjë prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, jo vetëm që nuk është specialist i fushës (si për referuar objektin konkret të prokurimit, ashtu edhe fushës së prokurimit publik), por nuk kanë kryer asnjë trajnim mbi prokurimet publike.

Në këto kushte, asnjë prej anëtarëve të mësipërm

të komisionit të vlerësimit të ofertave nuk ka aftësitë e duhura ligjore, teknike dhe profesionale për të bërë vlerësimin e ofertave që kanë marrë pjesë në tender.

Gjithashtu, në dosjen e prokurimit administrohen edhe tri shkresa të tjera lidhur me përcaktimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, në të cilat rezulton se AK ka lënë bosh pa plotësuar numrin e protokollit, ashtu edhe datën e shkresës, ndërkohë që të tria këto shkresa janë me nënshkrimin e ish-titullarit të institucionit, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi protokollistja e institucionit, znj. Megi Kosovari, për veprime në kundërshtim me Ligjin "Për arkivat".


Gjithashtu, lidhur me këtë verifikim, veprime të tilla ku lihen datat dhe numri i protokollit bosh pa plotësuar përbëjnë precedent për një procedurë prokurimi jo konform kuadrin rregullativ.

Lidhur me sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi ligjore ish-titullari i AK, Alban Ramohitaj si personi përgjegjës, i cili ka nxjerrë edhe urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, ku bazuar në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, titullari i AK është personi përgjegjës për nxjerrjen e urdhrave përkatës.

Gjithashtu, në urdhrin

ARGUMENTIMI

Me iniciativën e saj ka bërë ndryshimin e kërkesave për kualifikim, duke rritur kërkesën për vlerën e xhiros nga 40% në 100% të vlerës së fondit limit, ndërkohë që komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës ka bërë ndryshimin e kësaj vlere nga 100% në 40% të vlerës së fondit limit, me qëllim rritjen e konkurrencës në prokurim. Ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, ndërkohë që në këtë raport mungojnë elementet thelbësore, ashtu sikurse parashikohet në LPP.



për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave datë 28.04.2017, titullari i AK ka përcaktuar se data e zhvillimit të procedurës së jetë data 26.05.2017 ora 13:00, ndërkohë që një veprim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore.

Kjo për faktin se, në datën dhe momentin që ky titullar ka përcaktuar edhe datën e procedurës së prokurimit, akoma njësjë e prokurimit nuk ishte mbledhur për të përcaktuar, hartuar dhe miratuar kërkesat për kualifikim.

Kjo provohet dhe vërtetohet edhe sipas shkresës nr. 502/8 prot., datë 28.04.2017, datë në të cilën janë hartuar dhe miratuar kërkesat për kualifikim.

Pra, kompetenca që titullari i AK të përcaktojë datën e hapjes së tenderit nuk gjen mbështetje ligjore. Kjo për faktin se, bazuar në LPP, datën dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, e përcaktuar njësjë e prokurimit, pasi të jenë hartuar dhe miratuar kërkesat për kualifikim dokumentet e tenderit etj.

Sa më sipër provohet dhe vërtetohet se kjo procedurë

prokurimi ka qenë e pasaktë, pasi në asnjë rast nuk mund të provohet dot se titullari ka njohuri se sa kohë do t'i duhet njësisë se prokurimit për të hartuar dokumentet e tenderit.

Lidhur sa më sipër, mban përgjegjësi ligjore ish-titullari i AK, Z. Alban Ramohitaj.

2. Znj. Viola Cikalleshi, me detyrë ish-drejtoreshë në spitalin rajonal, Durrës, aktualisht punonjëse e sektorit të prokurimeve, gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, gjë që ka sjellë direkt ose indirekt përveç të tjerash, përfitime nga persona të ndryshëm, e konkretisht:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Furnizimi i shërbimit të lavanterisë për spitalin rajonal Durrës" me fond limit 166,666,500 lekë pa TVSH, rezultoi se: Në këtë procedurë prokurimi ka qenë edhe anëtarë e njësisë së prokurimit, ku ka nënshkruar në dokumentet e tenderit, njëkohësisht ka bërë edhe miratimin e raportit

përmbledhës në cilësinë e titullarit të AK.

Ka vendosur dhe përcaktuar edhe kërkesat për kualifikim, ndërkohë që ka qenë titullar i AK, shkelje flagrante e LPP, pasi ka vendosur për kërkesat për kualifikim me iniciativën e saj, pa pasur ankesë në dispozicion ku për më tepër, ankesës i është kthyer përgjigje nga KSHA, që pretendimet e ngritura nuk qëndrojnë.

I ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese "Shpresa sh.p.k.", ndërkohë që ankesa nuk është shqyrtuar e plotë, pasi nuk është marrë në konsideratë pjesa e pretendimeve lidhur me kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik të shpallur fitues nga AK.

U ka kthyer përgjigje shoqërive ankuese, sipas të cilave ka konkluduar se nuk merren në konsideratë pretendimet e ngritura, ndërkohë ka bërë modifikimin e kërkesave për kualifikim, ku një kompetencë e tillë nuk është e titullarit të AK.

Në kushtet e shkeljeve flagrante të ligjit, nuk duhet të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës, i cili është në kundërshtim me LPP.

Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, ka nënshkruar kontratën vetëm me një operator ekonomik, ndërkohë që shoqëria fituese është bashkim operatorësh ekonomikë.

Ka miratuar një raport

DËMI NE BUXHETIN E SHTETIT

"Nga KVO, KSHA dhe titullari i AK është kualifikuar në mënyrë të padrejtë OE fitues, për arsye se oferta më e ulët e paraqitur është kualifikuar në kundërshtim me ligjin dhe kërkesat për kualifikim, si dhe në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP, duke përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse dhe diferenca ndërmjet ofertës së shpallur fituese dhe asaj të kualifikuar prej 142,857,000 - 121,333,212 = 21,523,788 + 20% TVSH = 25,828,545 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit".

përmbledhës, ku është pasqyruar se bashkimi i operatorëve ekonomikë me vlerë më të ulët duhet të kualifikohet, pasi kryesuesi/përfaqësuesi është anëtar i që ka marrë përsipër të realizojë 19.3% të kontratës së bashkëpunimit, ndërkohë që edhe operatori ekonomik fitues, me të cilin është lidhur edhe kontrata nga znj. Viola Cikalleshi, përfaqësuesi/kryesuesi ka marrë përsipër të realizojë vetëm 10% sipas kontratës së bashkëpunimit, pra duke mbajtur dy standarde/qëndrime.

Me iniciativën e saj ka bërë ndryshimin e kërkesave për kualifikim, duke rritur kërkesën për vlerën e xhiros nga 40% në 100% të vlerës së fondit limit, ndërkohë që komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës ka bërë ndryshimin e kësaj vlere nga 100% në 40% të vlerës së fondit limit, me qëllim rritjen e konkurrencës në prokurim.

Ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, ndërkohë që në këtë raport mungojnë elementet thelbësore, ashtu sikurse parashikohet në LPP.

Ka bërë miratimin e raportit përmbledhës, në të cilin janë pasqyruar arsye, të cilat nuk janë dhënë si kualifikim nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, si dhe në raportin përmbledhës nuk janë pasqyruar të detajuara ankesat në KPP.

KORÇË - Prokuroria e Korçës ka pushuar çështjen në lidhje me vdekjen e 27-vjeçarit Enea Ftoi në ambientet e komisariatit të këtij qyteti. Disa muaj pas ngjarjes, prokuroria e çështjes ka dalë në konkluzionin se policia nuk ka ushtruar dhunë, por i riu vuanë nga një sëmundje në mushkëri. Prokurorja Oli Visi është shprehur mes tjerash se çështja do i dërgohet gjykatës së Korçës, pasi siç tha ajo 27 vjeçari vdiq nga



Enea Ftoi

Reagojnë familjarët: Vendimi korruptiv, do bëjmë vetëgjyqësi

Prokuroria pushon çështjen për vdekjen e Enea Ftoi, nuk u dhunua, vdiq nga problemet në mushkëri

ishemia akute e miokardit dhe rezultonte se kishte probleme të theksuara në mushkëri. Mes tjerash prokurorja ka konstatuar se nuk ka vepr penale pavarësisht pretendimeve të familjarëve, ndërsa

pas hetimeve dhe analizave është konfirmuar se Ftoi ishte përdorues i lëndëve narkotike. Pas vendimit të Prokurorisë për të mbyllur çështjen në fjalë kanë reaguar menjëherë familjarët, të cilët

kanë cilësuar këtë veprim si korruptiv. Babai i të ndjerit, Guri Ftoi ka hedhur poshtë konkluzionet se policia nuk kishte ushtruar dhunë, pasi sipas tij, djali kishte krahun e thyer. "Vendimi i Prokurorisë

është i padrejtë. Nuk e pranojmë vendimin. Policia ka ushtruar dhunë ndaj Eneas. Në trup kishte shenja dhune. Krahun e kishte të thyer, gjuhën të prerë. Vendimi i prokurorisë, korruptiv. Do bëj vetëgjyqësi. I bëj thirrje Arta Markut të bëjë veting për prokurorët e Korçës. Duam të dalë e vërteta. Enea na tha kur ishte i shoqëruar, që po me torturojnë. Akuzoj policinë e Korçës për vdekjen e Enea dhe fshehjen e provave", tha Guri Ftoi.

Lënda narkotike me destinacion Italinë. Operacioni në bashkëpunim me Guardia di Finanza

FIER/VLORË

Një gomone me një sasi prej 1 ton drogë është bllokuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në grykëderdhjen lumit Vjosa. Pas pikasjes në det nga policia, trafikantët u detyruan që të mos vijonin rrugën drejt Italisë, por u kthyen në grykëderdhjen e lumit në fjalë, ku braktisën mjetin dhe më pas u arratisën në këmbë drejt pyllit. Në lidhje me sekuestrimin e gomones 10 metër të gjatë, Policia e Shtetit ka dhënë detaje nga operacioni i koduar "Vjosa". Sipas bluve, në këtë operacion u angazhuan Policia Kufitare e Vlorës, Policët Vendore të Fierit dhe Vlorës, FNSH dhe Guardia di Finanza. "Policia e Shtetit në bashkëpunim me partnerët e Guardia di Finanza-s kanë parandaluar një tentativë për trafik lënde narkotike përmes detit drejt Italisë. Operacioni nisi rreth orës 03:30 të mëngjesit, kur u pikas mjeti lundrues disa milje në det. Policia Kufitare e Vlorës dhe GdF kanë vijuar ndjekjen në det. Forcat operacionale të FNSH-së Fier dhe të Policisë lokale Fier e Vlorë kanë organizuar punën duke patrulluar me disa grupe nga foka, me gjithë kushtet e vështira të motit. Ndjekja policore detyroi trafikantët të futeshin në grykëderdhjen e lumit. Trafikantët braktisën mjetin lundrues dhe lëndën narkotike në buzë të

Sekuestrohet gomonia me 1 ton drogë në grykëderdhjen e lumit Vjosa

Trafikantët braktisën mjetin, u arratisën në pyll



Droga e sekuestruar në gomone

lumit Vjosë, pranë fshatit Bishan. Duke përfutur nga errësira, të dyshuarit janë larguar në drejtim të pyllit. Forcat e Policisë kanë rrethuar zonën dhe vijojnë ndjekjen për kapjen e tyre", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, mësohet se policia sekuestroi 1 mjet lundrues, 2 automjete, një sasi lënde narkotike e dyshuar kanabis, si dhe prova të tjera që ndihmojnë hetimin. Nën drejtimin e një grupi të posaçëm po vijojnë hetimet intensive për ndalimin e personave të përfshirë në këtë aktivitet kriminal dhe përballjen e tyre me drejtësinë.

iane brenda një kohe të shkurtër. Sasia e saktë e lëndës narkotike nuk dihet ende. Mund të jenë 800-1000 kg. Dyshohet se kanë qenë dy persona me gomonen që janë larguar në drejtim të pyllit në fshatin Bishan. Policia ka gjetur dhe gjurmë dhe dokumente, por nuk jepen informacione për shkak të hetimeve", thanë burimet e mësipërme.

OPERACIONI NË ITALI

Pas një operacioni të Guardia di Finanza, dje në Firence janë sekuestruar 540 kg marijuanë dhe 18 të tjera kokainë. Sipas mediave italiane, në pranga kanë përfunduar 14 persona, mes tyre edhe shqiptarë. Sasia e drogës trafikohet me anë të autobusëve të linjës së një shoqërie transporti me qendër në Milano dhe më pas transportohet nga Holanda e Belgjika. Pas këtij itinerari, kjo sasi mbërrinte në Milano duke u shpërndarë në rajonin e Lombardisë. Sipas mediave italiane, truri i këtij grupi trafikantësh ishte një shqiptar me banim në qytetin Prato

Ndërkohë, burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se FNSH dhe Delta Force kanë ushtruar kontrollë në afërsi të fshatit Bishan. Sipas këtyre burimeve, gomonia është transportuar në Triport, ndërsa nuk është e regjistruar në Shqipëri. "Mjeti është i përshtatur dhe s'ka sinjalistikë. Me dy motorë të fuqishëm, gomonia (kishte dhe një mbulesë) mund të arrinte brigjet ital-

Grabitet dhe qëllohet me thikë kambisti

MEMALIAJ - Persona të paidentifikuar kanë qëlluar me thikë një kambist dhe gruan e tij në qytetin e Memaliajt. Sipas të dhënave të para ngjarja ka ndodhur në momentin kur çifti i bashkëshortëve po mbyllte biznesin e tyre. Pre e dhunës kanë rënë Mustafa Mustafaj, 70 vjeç dhe bashkëshortja, Thëllëza. Ata janë qëlluar me thikë nga grabitësit dhe për pasojë janë transportuar me urgjencë në spital ku ndodhen në gjendje të rëndë për jetën. Dyshohet se grabitësit kanë marrë një shumë të konsiderueshme parash dhe më pas janë larguar.

FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

Thirrje për projekt-propozime

"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në komunitet në Shqipëri, shpalli Thirrjen Nr.3 Për Aplikime.

Organizata Joffitimpurisë (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Grantëve të këtij Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr.3, e cila do zbatohet në qarqet Vlorë, Lezhë, Korçë dhe Elbasan. Inkuajshjen të aplikojnë organizata me seli në zonat ku parashikohet të zbatohet thirrja dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkitë Qendër Oarku (Vlorë, Lezhë, Korçë dhe Elbasan) por edhe bashkitë e tjera përberëse (psh. Sarandë, Mërkuritë, Kolonjë etj.), apo njësitë administrative të tyre.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto zona, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-aplikimi me një organizatë lokale/aktive lokale duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë tre lloj grantesh:

- Grante deri në 15,000 €
- Grante deri në 10,000 €

Këto grante do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të koalicionëve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe komuniteteve vendore si dhe mijen e besimit të ndërsjellë dhe; b) Përmirësimin e ndërvëprimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmeve lokale të reformimit, për mijen e cilësisë së masave parandaluese dhe mijen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Afati kohor për zbatimin e projektit: deri në 18 muaj

Grante deri në 5,000 € të cilat do të mbështesin projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus rritjen, si iniciativë në fushën e zgjidhjes së konfliktëve, ndërgjegjësimin, pasqijt e përdorimit të drogëve dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun rrugor, bulizmin dhe krimin kibernetik, trafikimin e qenave njerëzore, krimet homobloke, ekstremizmin e dhunshëm, etj; me theks të veçantë në masat parandaluese. Afati kohor: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formulart të Aplikimit të Udhëzuesit për Aplikime. Të dy këto dokumente mund të konsultohen / shkarkohen nga linku <http://www.cp-project.al/skema-e-grantave/>

Aplikimi dhe dokumentet mbështetëse (lista e të cilave gjenden tek Udhëzuesi për Aplikime, 5.2.5 Kriteret e Vlerësimit) duhen dorëzuar deri në datën 21 Shkurt 2019, ora 17:00. Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al/>

unicef | for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES

Subject: Develop and implement a model for the digitalization of birth - related records and their online transfer from maternities to Primary Health Care facilities.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (<https://www.unicef.org/albania/suppliers-and-service-providers/>) or UN Albania website (<http://www.un.org.al/employment-and-procurement/>) to download the detailed RFPS document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked:

"LRPS-2019-9146183 - Provision of the communication, public relations, event organization and coordination services to promote the child and family - friendly Wi-Fi in public spaces in Tirana and beyond." to the following address:

United Nations Children's Fund (UNICEF)
Tr. "Skënderbej", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel. +355 44548400; Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies must submit their application, not later than **06 February 2019, 16:00 hrs.**

Opinion i Ditës

Keqkuptimet me liberalizmin dhe kërcënimi ndaj tregut të lirë

Nga Adri Nurellari

Debati publik për strukturën e ekonomisë shqiptare po i jep jehonë gjithnjë e më të madhe shoqësisë për formimin e një oligarkie, e cila ka përdoruar në pak duar, pjesën kryesore të ekonomisë. Në opinionin e qytetarëve është duke u çimentuar bindja se që të bëhesh biznesmen i fuqishëm sot duhet të kesh lidhje të ngushta me politikën e krimin. Pra, suksesin në ekonomi nuk e shohin si rezultat të punës së palodhur, kurajës për të marrë përsipër risk, arsim dhe talent, por si produkt të drejtëpërdrejtë të sigurimit të përfitimeve e privilegjeve prej shtetit. Pra, rruga drejt fuqimit duket se është shtrydhja e favoreve nga shteti duke marrë tendera, subvencione, amnisti, licenca, koncesione apo imunitet për evazion fiskal e kontrabandë. Po ashtu, përdorin qeverinë për të eliminuar apo kufizuar konkurrencën duke minimizuar lirinë e konsumatorit për të zgjedhur. Kjo rrugë shkon tërësisht ndesh me vlerat dhe parimet që promovon liberalizmi e që konsistojnë në sipërmarrje private që funksionon në kushtet e tregtisë së hapur e të lirë, konkurrencës së lirë e të ndershme, sundimit të plotë të ligjit dhe të një qeverie që nuk i fut hundët në ekonomi, por qëndron e distancuar dhe neutrale në treg.

Fatkeqësisht gjë reputacion negativ që më të drejtë kanë marrë këto biznese të mëdha është duke u shfrytëzuar manipuluar nga neomarksistët shqiptarë, të cilët po e lidhin me liberalizmit klasik apo neoliberalizmit sikurse i referohen shpesh. Krijimin e kësaj kaste biznesmenësh shqiptarë të kapitalizmit të kalbur apo "crony capitalism" sikurse po i referohen shpesh nëpër botë, ata po e trajtojnë si të ishte pasojë e aplikimit të plotë të sistemit ekonomikopolitik të liberalizmit demokratik. Mirëpo ky është një spekulim i pastër që vjen nga e majta ekstreme, sepse ka një dallim të madh mes të qenurit pro-tregut dhe pro-tregtarëve, mes të qenurit pro-biznesit si veprimtari ekonomike dhe pro-biznesmenëve të veçantë.

Që në hapat e parë të mendimit ekonomik liberal është bërë një dallim i qartë mes mbrojtjes së ekonomisë së tregut dhe mbrojtjes së interesit të biznesmenëve. Filozofi i parë liberal, Adam Smith, në kryeveprën e tij "Pasuria e Kombeve", kishte si një ndër temat kryesore kundërshtimin e merkantilizmit. Pra, dilte kundër favorizimit të bizneseve të veçanta që shteti bënte duke penguar konkurrencën që vinte nga mallrat e importuara. Babai i ekonomisë si disiplinë shkencore, në këtë mënyrë kritikonte politikat pro-biznesit që siguronin përfitime për disa të privilegjuar dhe promovonte tregtinë e lirë që i shërben të gjithëve. Po ashtu, një tjetër shoqësim që paraqet ai në atë liber të shekullit XIX është rreziku që vjen nga monopole të



karrete. Ai vinte në dukje se nëse bëhen me njëri-tjetrin biznesmenët e një sektori, e pëson interesi publik sepse rriten artificialisht çmimet. Po ashtu, këshillat e tij vlejën edhe për sot kur ai kërkon maksimumin e vigjilencës përkundërt përpjekjeve të biznesmenëve për të përdorur lidhjet politike në interes të tyre. Sipas tij, "Propozimi i çdo ligji apo rregulloreje të re që vjen nga biznesmenët, duhet të dëgjuar me kujdes të madh dhe nuk duhet të miratohet derisa të jetë shqyrtuar shtruar me kujdes... me dyshimin më të madh pasi vjen një lloj njerëzish, që nuk i kanë interesat të njëjta me ato të publikut".

Përpos kësaj, duhet pasur parasysh se biznese private kishte edhe më herët se epoka e Adam Smithit. Ideologjia e deriatëhershme dhe vetë mënyra si funksiononin gjërat para përqafimit të liberalizmit, konsistonin tashmë në ruajtjen e status quo-së dhe privilegjeve të më të pasurve dhe më të fuqishmëve. Demokracia në Angli asokohe ishte rudimentare dhe të drejtën e votës e kishin vetëm meshkuj që duhej të ishin të pasur. Mendimi i Adam Smith ishte kundër status quo-së dhe sigurimit të privilegjeve dhe pro konkurrencës, iniciativës private e novacionit. Prandaj ide të tij duhen konsideruar si propozime që më shumë ofronin mundësi për më të varfrit e më të dobëtit sesa për të pasurit e të fuqishmit që tashmë e dominonin shoqërinë. Thelbi i tezës së tij, që përbën edhe zanafillën e liberalizmit, është se tendenca e natyros e njerëzve drejt interesit vetjak sjell begatinë për gjithë shoqërinë prandaj për të pasur përparim më të madhe duhej që të hapeshin tregjet, të promovohet konkurrenca dhe qeveria të ndërhynte sa më pak në ekonomi.

Dallimin mes liberalizmit dhe interesave të biznesmenëve e bën të qartë akoma më mirë një nga mendimtarët më të rëndësishëm bashkëkohor të kësaj doktrine ekonomike e politike. Në një intervistë në 1974, Milton Friedman thoshte se, "dy armiqtë më të mëdhenj të të shoqërisë së lirë ose sipërmarrjes së lirë janë intelektualë

nga njëra anë dhe biznesmenët nga ana tjetër, për arsye të kundërta. Çdo intelektual beson në lirinë për veten, por është kundër lirisë për të tjerët. Ai dëshiron lirinë e fjalës, lirinë akademike mirëpo kur vjen puna tek ekonomia... Ai mendon se duhet të ketë një bord të planifikimit qëndror që do të krijojë përparësitë shoqërore. Biznesmenët janë thjeshtë e kundërta - çdo biznesmen është në favor të lirisë për të gjithë të tjerët, por kur bëhet fjalë për vete, sipas tyre kjo është një çështje tjetër. Ai mendon se gjithmonë rasti i veçantë. Ai mendon se meriton të marrë privilegje të veçanta nga qeveria. Ata thonë duhet të kemi këtë tarifë doganore për të mbrojtur prej konkurrencës që vjen nga jashtë. Ne duhet të kemi atë lehtësim në taksat. Ne duhet ta kemi këtë subvencion".

Trajtimi i liberalizmit si një ideologji që promovon ekskluzivisht interesat e biznesmenëve është në fakt një rudiment apo reminiscencë e trashëgjuar nga teoria marksiste e klasave. Për ta përmblodhur shpejt e shkurt, Marksist mendonte se pozicioni i një individi në shoqëri lidhet me rolin që ai ka në procesin e prodhimit dhe më konkretisht me zotërimin ose jo të mjetëve të prodhimit. Klasa përbëhet nga individë që kanë gjendje dhe interesa të përbashkëta ekonomike, janë të vetëdijshëm për ato interesa dhe angazhohen në veprime kolektive që i çojnë përpara ato interesa. Sipas Marksit, historia shikohet bazuar në antagonizmin e pashmangshëm mes dy shtresave, duke shprehur bindjen se shoqëria ecën përpara nëpërmjet luftës së dy klasave. Në një anë ai thoshte se është proletariati që konsiderohet klasa e punëtorëve që nuk ka pronë mjetet prodhimi, por të ardhurat i sigurojnë nga shitja e fuqisë së tyre të punës. Nga shiata tjetër, borgjezia që është klasa sociale që gjatë industrializimit ka shtënë në dorë mjetet e prodhimit dhe që ka për prioritet kryesor mbrojtjen apo rritjen e vlerës së pronës dhe kapitalit të tyre, duke ruajtur kështu dominimin në shoqëri. Pra, thënë thjeshtë, nëse

individit zotëronte mjetet e prodhimit ishte borgjez dhe nëse jo, ishte proletar.

Ajo që duhet theksuar është se teoria marksiste mendonte se çdo klase i korrespondon një ideologji specifike që përfaqëson më së miri interesat, vullnetin apo dëshirat e pjesëtarëve të asaj klase. Kështu, komunizmi ishte doktrina që parashtronte rrugën e çlirimit të proletariatit nëpërmjet revolucionit. Me këtë frymë të materializmit historik, edhe liberalizmi është konsideruar e trajtuar si doktrina politike që mburon e mbështet kapitalistët apo borgjezët. Pra, në njëfarë mënyre duke folur përditë për shtresën e mesme si mbështetëse e natyroshe e sistemit kapitalist apo liberalizmit, thjeshtë aplikohet teoria marksiste e klasave. Në fakt, liberalizmi nuk duhet parë me një sy marksist, sepse është një ideologji që promovon lirinë në vetvete, pavarësisht se kush përfiton prej saj. U bë kohë që është hedhur poshtë mënyra materialiste marksiste e të parit të individit si një dele brenda një kopeje që s'ka individualitet, por që i përket një shtrese dhe reflekton kryekëput interesat e asaj shtrese. Në shkencat sociale të epokës së sotshme vlerësohet dhe respektohet individi dhe individualiteti dhe njerëzit nuk trajtohen vetëm si pjesëtarë të një klase monolite.

Në epokën post-industriale që po përjeton Evropa, përqindja e klasës punëtore apo shtresës së ulët ka rënë shumë, ndërkohë që shumica dërrmuese i përket shtresës së mesme. Kështu, sipas organizatës OECD, përqindja e shtresës së mesme në Danimarkë është 80%, Finlandë 75%, Francë 74%, Gjermani 72%, Irlandë 69%, Itali 67%, Luksemburg 75%, Holandë 79%, Norvegji 80%, Mbretëri të Bashkuar 67% e kështu me radhë. Mirëpo pavarësisht rritjes së përqindjes së popullsisë që i takon shtresës së mesme, liberalizmi si ideologji nuk gëzon mbështetjen të njëjtë me këto përmasa sikurse do të pretendonte marksizmi me këto shifra, përkundrazi, një pjesë e mirë e shoqërisë ende beson tek

ndërhyrja fortë kapilare e shtetit në ekonomi. Po ashtu, edhe pse përqindja e proletarëve, pra qytetarëve që nuk zotërojnë mjetet e prodhimit ka rënë jashtëzakonisht, ideat e frymëzuara nga Marksist janë ende të forta shoqëri dhe e majta që promovon barazimin nëpërmjet rishpërndarjes ende fiton rregullisht zgjedhje në këtë Evropë të dominuar nga shtresa e mesme. Kjo situatë tregon se sa e paqëndrueshme është sot teoria e klasave e Marksist.

Por, edhe sikur ta merrnim hipotetishtë të mirëqenë atë teori, për hir të së vërtetës duhet thënë se historia bashkëkohore ka dëshmuar që liberalizmi më së miri u ka shërbyer interesave të varfërve. Liberalizmi jo vetëm që triumfoi mbi komunizmin, por përhapja e tij ka nxjerrë nga varfëria qindra milionë qytetarë të Kinës, Indisë e vendeve të tjera ku po aplikohet. Studiuesi Johan Norberg në kuadër të sfidës së dhjetëvjeçarit 2008-2018 që ka qarkulluar kohëve të fundit ka nxjerrë në pah disa të dhëna interesante që nxjerrin në pah suksesin e përhapjes së lirisë dhe ekonomisë së tregut nëpër botë. Të dhënat e nxjerra nga organizata si UNDP, Banka Botërore dhe UNESCO tregojnë se varfëria ekstreme ka rënë nga 21.3% në 2008 në 8.6% në 2018, vdekshmëria foshnjore nga 5.8% në 3.8%, alfabetizimi nga 11.3% në 8.6% ndër-sa jetëgjatësia është rritur nga 69.8% në 72.2%.

E vërteta është se në shumë raste biznesmenët e pëlqejnë dhe e mbështesin idenë e tregut të lirë deri sa të futen në treg, më pas bëjnë çmos që të pengojnë të tjerët që të hyjnë, kryesisht duke u përpjekur që të merren me politikë. Bizneset kanë bërë çmos për të shpangur presionet, rreziqet apo parashikueshmëritë që shkaktohen prej një konkurrence të lirë e të ndershme dhe shpesh përdorin ndihmën e qeverisë për të evituar konkurrencën. Aktualisht konsumatori shtet është konsumatori kryesor e jo konsumatori individ i thjeshtë. Duke qenë se është shteti është ai që gjithnjë e më shumë vendos për suksesin apo dështimin e një biznesi, e jo konsumatori, atëherë bizneset kanalizojnë gjithnjë e më shumë energji e burime për të siguruar privilegje nga shteti, duke kështu shpërfillur gjithnjë e më shumë përmshjen e konsumatorit. Kjo gjë stimulon edhe kalbjen e demokracisë, sepse nëse shteti e ka ndërhyrjen në ekonomi të madhe, atëherë biznesmenët kanë interes gjithnjë e më shumë që të kenë ndikim në politikë duke korruptuar lobuar, financuar parti apo garuar vetë në parlament. Prandaj në qendër të ideologjisë liberale qëndron ideja e miniarkisë, domethënë e një qeverisje sa më të vogël, e taksave dhe shpenzimeve qeveritare sa më të vogla, në mënyrë që suksesin i bizneseve të jenë gjithnjë e më shumë në varësi të konsumatorit e jo të qeverisë dhe lojës politike.

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 23 Janar 2019 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Azilanti Gruevski filmohet duke bërë 'shopping' në Hungari
- Komentuesi, Bregut: Mendova se kishe nisur punë në BE, jo në bashki
- "Trojet e të parëve", Ndreu: Aty mbretër janë të tanë
- Taulant Balla "tradhton" Bajernin, shfaqet me bluzën e Arsenalit

Ditë speciale për familjen, Ilva Tare uron bashkëshortin në mënyrë unike



Shpërthen Linda Halimi: Ende s'kam marrë borxhet nga RTSH!



Nga Alban Ramosaj te Roza Lati, njerëzit e famshëm që parapëlqejnë lakuriqësinë



Nudo artistike apo provokuese? VIP-at që guxuan të zhvishen

*Kush kërkon famë e kush e ka pasion,
fotot që tërbuan rrjetet*

Nga Alban Ramosaj te Roza Lati, njerëzit e famshëm që parapëlqejnë lakuriqësinë

Nudo artistike apo provokuese? Ja VIP-at që guxuan të zhvishen

Kush kërkon famë e kush e ka pasion, fotot që tërbuan rrjetet

Pamela Aliaj

Të zhveshurit nudo nuk është një gjë që përbën dhe aq zhurmë ditët e sotme, por nëse ka të bëjë me një zgjedhje personale të ndonjë personazhi të njohur, të gjithë jemi sy e veshë. Nuk dihet ende se përse të gjithë jemi të gatshëm që të paragjykojmë një preferencë të dikujt tjetër, por fakti që ai apo ajo ka dalë nudo na bën shumë përshtypje dhe një lajm i tillë bëhet viral për një kohë të konsiderueshme. Vëmendjen kësaj radhe për të dalë nudo e tërhoqi këngëtarja i njohur, Alban Ramosaj, i cili së fundmi postoi një foto në faqen e tij në "Instagram". Nuk është i pari mashkull që del lakuriq, por me siguri nuk do të jetë as i fundit. Më poshtë listojmë disa nga personazhet tona VIP, të cilët kanë eksperimentuar edhe me këtë anë të fotografisë apo edhe dëshirës për të shfaqur lakuriqësinë e tyre.

ALBAN RAMOSAJ

Alban Ramosaj i ka befasuar të gjithë kur ka postuar në "Instagram" një fotografi ku shihet pa asnjë rrobë në trup. Komente et ishin të shumta në drejtim të tij, përdherisa shoqëria e tij qeshnin me të, por kishte dhe nga ata që lëshuan komentet negative apo dhe të tjerë që bënë meme me të. Por, komentit i nënës së tij po habit më shumë se vetë fo-



Rezarta Shkurta

tografia e këngëtarit, duke e cilësuar si art atë që djali i saj ka bërë. "Skulpturë Mikelangelo # art", shkruan nëna e Albanit, Antigona, i cili ia kthen me të qeshur, duke vazhduar më tej: "O jeta s'ke ftohtë?". Pra, mund të shihet edhe arsyeja e një fotoje të tillë apo jo?

REZARTA SHKURTA

Rezarta Shkurta është cilësuar nga mediat shqiptare si një artiste që joshet pas fotografimit nudo. Këngëtarja para disa vitesh publikoi disa fotografi të reja ku ajo shfaqet e tëra e zhveshur, duke fshehur vetëm pjesët

intime. Ajo edhe më herët kishte pozuar në foto seksi dhe erotike, por fotot e poshtme janë hera e parë që ajo nuk vendos asnjë leckë në trupin e saj. Në një foto tjetër nudo, Rezarta duket e shtrirë në rërë me asnjë mbulesë rreth trupit, duke lënë vetëm pjesët intime nën hije. Rrezarta më herët kishte shfaqur pasionin e saj jo vetëm për t'u fotografuar, por edhe për të bërë foto.

BLEONA QERETI

Bleona Qereti është një nga këngëtarët që ka guxuar gjithmonë me nudon. Këngëtarja sh-



Kallashi



Genta Gjalpi



Roza Lati

qiptare vazhdon të mos e ketë aspak problem të dalë lakuriq dhe këtë e tregon haptazi me fotot që publikon herë pas here. Në një video të postuar në rrjetet sociale, ajo po realizon një set të ri fotografik totalisht e zhveshur. Fansat e saj kanë pasur mundësi t'i shohin fotot e publikuara, por jo mënyrën se si janë realizuar ato. Bleona është një këngëtare, e cila përpigjet gjithmonë të bjerë në sy dhe ia dalë të marrë komente dhe pëlqime nga fansat e saj.

FJOLLA MORINA

Fjolla Morina i ka përhëndë-

tur miqtë e saj direkt nga vaska para disa kohësh. Fjolla ka qenë e mbuluar më së shumti nga shkuma. Ajo e shoqëronte qëndrimin në vaskë me një gotë shampanjë në dorë. Këngëtarja duket se e ka kaluar nën një relaks total mbrëmjen e djeshme dhe kjo ka qenë pikërisht fjala më të cilën e ka përkufizuar edhe vetë. Nëse ka qenë vetëm, apo e shoqëruar këtë nuk mund ta themi, por e rëndësishme është që ka kaluar mirë. Dikush që e ka fotografuar ka qenë aty. Foto të tilla nga vaska po publikohen gjithmonë e më shpesh. Nudo artistike?

KALLASHI

Kërcimtarja seksi e njohur tashmë për publikun "Kallashi" ka ditur të tërheqë vëmendjen me fotot e saj provokuese të një-pasnjëshme. Ajo ka postuar në rrjetet sociale një foto komplet nudo dhe shfaqet me një armë të tipit "Kallashnikov" në dorë. Kallashi ka treguar disa herë se ekspoziimi dhe zhveshja janë gjërat që ajo ka më qejf. Edhe Shkëndije Muja i ka hapur asaj "luftë" të hapur me foto sa më seksi. Të jetë ky provokim për të fituar vëmendjen?

GENA GJALPI

Ish-banorja e "Big Brother", e cila u dallua për guximin dhe mënyrën e të shprehurit drejt-përdrejtë, vazhdon ta shijojë jetën pa komplekse edhe pasi kanë kaluar disa vite nga eksperiencia në "Big Brother". Një natë lakuriq në pishinë duket se po e relakson vajzën nga fshati Baban i Devollit. Kjo shfaqet e Genta Gjalpit nuk është ndonjë surprizë, pas fotove të publikuara me të dashurin, ku ajo pozonte me të brendshme e me pistoletë në dorë.



Alban Ramosaj



Fjolla Morina



Rozana Radi



Adelina Ismaili



Bleona Qereti





Roza Lati




Dafina Zeqiri

Ajo është një nga këngëtaresht shqiptare, e cila prej vitesh vendosi të jetonte jashtë vendit. E kemi fjalën për Linda Halimin, e cila tashmë jeton në SHBA. Por, rreth dy vite më parë ajo fitoi festivalin e RTSH-së duke përfaqësuar kështu vendin tonë në Eurovizion. Së fundmi ajo u ka kthyer përgjigje disa prej pyetjeve nga ndjekësit e saj në "Instagram". Një nga pyetjet drejtuar këngëtares ka qenë: "A do riktheheshe në festivalin Kënga Magjike apo RTSH?" Por, përgjigja e Lindës ka habitur shumë, pasi ajo është shprehur: "Të ardhmes si dihet! Por, momentalisht RTSH akoma më ka borxh, kështu që s'besoj", - ka thënë



Shpërthen Linda Halimi: Ende s'kam marrë borxhet nga RTSH!

Bleona Qereti di gjithnjë si të bëjë të flasin për të dhe për sukseset e saj të njëpasnjëshme. Këtë herë këngëtarja, e cila po e vazhdon karrierën e saj në Amerikë, ka publikuar një foto ku shfaqet më seksi se kurrë. Në këtë foto ajo shfaqet e veshur tërësisht me të kuqe, ku gjithashtu ekspozon format e saj bombastike. Por, përveç fotos seksi, ajo ka bërë të ditur se kënga e saj "I don't need your love" është renditur në vendin e 3 në Billboard, nga vendi i 5-të që ishte pak ditë më parë. Duke qenë se ajo s'ka të ndalur, të shohim se cili do të jetë sukcesi i radhës!



Seksi në të kuqe, Bleona shënon suksesin e radhës, renditet e treta në Billboard



Ardian Bujupi së fundmi ka vendosur të bëjë një tatuazh të ri. Këngëtari ka prezantuar tatuazhin në rrjetet sociale, të cilin e ka bërë në dorën e djathtë. Ardiani ka përjetësuar në trupin e tij fjalën "RAHAT", që është edhe emri i albumit të tij të ardhshëm. Ndjekësit e përgëzuan zgjedhjen e bërë, si një mënyrë interesante kjo nga ana e Ardianit për të thënë se është mirë dhe gjërat i ka në vijë.

Përjetëson emrin në lëkurë, ç'kuptim ka tatuazhi i Ardian Bujupit?



Ajo është një nga personat publikë, e cila është treguar gjithmonë e rezervuar përsa i përket jetës së saj private. Postimet me fëmijët dhe partnerin e saj janë shumë të rralla, duke qenë se ajo nuk dëshiron t'i bëjë publike. Por në rastet të veçanta si ditëlindje apo përvjetorë, gazetarja i thyen rregullat. Kjo ndodhi së fundmi kur bashkëshorti i saj, Eduard Selami kishte ditëlindjen. Ajo ka zgjedhur ta urojë me një fotografi shumë speciale partnerin e saj. Duke bërë publike, Ilva postoi në "Instagram" një foto të Eduardit dhe vogëlushes së tyre, Melody me urimin "Gëzuar ditëlindjen babi!". Bukur, thjeshtë dhe e ndërjerë apo jo?

Ditë speciale për familjen, Ilva Tare uron bashkëshortin në mënyrë unike

BULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Azilanti Gruevski filmohet duke bërë 'shopping' në Hungari

Prej dy muajsh ish-kryeministri maqedonas, Nikolla Gruevski është arratisur në Hungari, ku ka kërkuar azil politik. Ai u largua nga vendi për t'iu shmangur dënimit me 2 vite burgim. Tashmë duket se po shijon jetën në Hungari si azilant. Mediat hungareze kanë publikuar së fundmi pamje të Nikolla Gruevskit në një qendër tregtare në Budapest. Në videon e shkurtër shihet se është i qetë, madje ka bërë edhe pazar. Nikolla Gruevski u arratis nga Maqedonia në muajin nëntor 2018, duke kaluar nga Shqipëria. Ai u ndihmua nga makina e ambasadës hungareze në Tiranë dhe më pas doli në kufirin malazez. Në doganë, ish-kryeministri Gruevski u lejua të kalonte pasi urdhri për ndalimin e tij doli dy ditë më vonë nga autoritetet maqedonase.



Komentuesi, Bregut: Mendova se kishe nisur punë në BE, jo në bashki

Pak ditë më parë Majlinda Bregu promovoi Tiranën në profilin e saj në "Twitter", duke ftuar miqtë e huaj ta vizitojnë, por një prej ndjekësve të saj nuk i ka kursyer ironinë. "Mendova se kishe filluar punë në BE dhe jo në bashkinë e supermashtresit që shpenzon miliona për fasada...", i shkruan ndjekësi sekretares e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Bregut, e cila tashmë jeton në Sarajevë. Por, ish-ministrja demokrate i kthehet prerë, duke i treguar kufirin: "Është detyra ime dhe nder të promovoj çdo qytet e kryeqytet në rajon! Dhe jo vetëm! Gjuhën mprehe diku tjetër për mllaf, tek unë STOP".



Taulant Balla "tradhton" Bajernin, shfaqet me bluzën e Arsenalit

Disa prej politikanëve veç pasionit dhe profesionit të politikës, janë edhe tifozë të zjarrtë të futbollit. Një prej tyre është edhe kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, i cili njihet nga të gjithë si një tifozë i hershëm dhe besnik i Bajernit të Mynihut. Shpeshherë atë e kemi parë në evente sportive me fanellën e skuadrës gjermane, ndërsa e bujshme në media ishte dhe vizita me ftesë të presidentit të Bajernit, Karl-Heinz Rummenigge, ku ai së bashku me kryeministrin Edi Rama ndoqën një nga ndeshjet e Bundesligës. Por dje Balla na është shfaqur në një aktivitet politik edhe me bluzën e një tjetre skuadre të famshme, kësaj here jo gjermane, por angleze. Ndërsa inspektonte në krah të Ramës punimet e autostradës Tiranë-Elbasan, Balla kishte veshur një bluzë të Arsenalit. Nuk dihet nëse ai ka simpati edhe për skuadrën e "topçinjve" apo kjo ishte një zgjedhje rastësore nga gardëroba e tij.



"Trojet e të parëve", Ndreu: Aty mbretër janë të tanë

Deputeti socialist, Pjerin Ndreu ka postuar disa foto nga ujëvara e Gojanit në Pukë, ndërsa është mahnitur nga bukuria e vendit. "Aty rrin hëna me zanë, aty mbretër janë të tanë. Në trojet e të parëve!", ka shkruar Ndreu mbi fotot e publikuara, ndërsa nuk e ka fshehur kënaqësinë që i ka dhënë ujëvara "e veshur" me akull e Gojanit.

Këshilla

Si është e mundur që disa njerëz janë të vjetër dhe të sëmurë, ndërsa të tjerët mbeten vitalë dhe shëndetplotë? Përse disa vdesin të rinj, ndërsa të tjerët përjetojnë një pleqëri të bukur? Cili është sekreti për një jetë të gjatë dhe të shëndetshme? Gjenetika, mënyra e jetesës, të ushqyerit, të gjithë këta faktorë luajnë një rol të madh në plakje dhe në paraqesim zakone të shëndetshme që mund të ju ndihmojnë të jetoni më gjatë.

HESHTNI

Proveni çdo ditë për gjysmë ore të heshtni dhe shikoni nga dritarja. Lejoni mendjen të ndjejë kontrollin e sjelljes tuaj. Mendimet qetësuese ngadalësojnë rrjedhjen e gjakut, ulin presionin dhe eliminojnë stresin.

ECJA

Çdo ditë, një shëtitje gjysmë ore në park apo fshat. Lëvizja aktivizon trupin dhe hap mendjen. Ajri i pastër dhe ritmi i hapave stimulojnë zemrën dhe sistemin e qarkullimit të gjakut për të punuar më mirë.

DASHURIA

Dashuria shëron - Disa hulumtime tregojnë se hormoni oksitocinë sekretohet tashmë në sytë e një të dashuri, e cila zvogëlon dhimbjen dhe përmirëson jetën.

LËRËNI CIGAREN

Ju kenë vrarë veten me 4.000 kimikate, disa prej të cilave janë 'Pure Poison' (p.sh. arsenik).

JETONI JETËN PLOTËSISHT

Në ritmin e sotëm të shpejtë shpesh bëjnë më shumë gjëra në të njëjtën kohë dhe harrojmë të shijojmë gjërat e zakonshme. Ndonjëherë ju duhet të relaksoheni dhe të kërkoni për kënaqësi në atë që bëni. Zhvilloni një qëndrim pozitiv në jetë dhe shihni gëzimet e vogla. Kjo do të ndihmojë në forcimin e sistemit imunitar dhe të përgatitjes trupin për të luftuar sëmundjen. Vendosni qëllime reale, sepse ato i japin kuptim jetës sonë.

HANI USHQIMIN NË FORMËN E VET ORIGJINALE!

Ushqimi në formë të tij natyror është i plotë me vlera ushqyese, ndërsa gati i ndryshon përbërjen kimike dhe ul vlerat. Pjekja është metoda më e mirë e përgatitjes së ushqimit për shkak se ajo mban vetitë më natyrore. Mënyra më e mirë për të mbajtur shëndetin tuaj është duke ngrënë disa fruta dhe perime të papërpunuara në ditë.

SHMANGNI HIPERAKTIVITETIN

Shëndeti nuk ka çmim! Çfarë është më e vlefshme se bilanci i llogarisë.



Dëshironi një jetë të gjatë e të shëndetshme? Ja 7 këshilla që duhet t'i ndiqni



Ministria e Financave: Keni edhe 2 javë kohë për të plotësuar dokumentet

Ish-të përndjekurit, 1000 trashëgimtarët që marrin paratë

Përfituesit do të marrin këstin e tretë

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave brenda 2 javëve dokumentet që iu mungojnë në dosje për të mos humbur të drejtën për të marrë paratë. Burime zyrtare nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se janë mbi 1000 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të cilët duhet të plotësojnë dosjet për të filluar pagesat e kështit të tretë. Sipas të njëjtave burime, mësohet se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të

sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rast

të kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoem os që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në cer-

tifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkripime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

Ligi parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzis-

tojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMRAT E TRASHËGIMTARËVE QË MARRIN PARATË

EMER	ATESIA	NAUN	TUNI	PAVLIN	XHEMAL	SHPRESA	SHUKRI	LUSH	PASHUK	ARJOLA	MUSTAFA
MARTA	LOLI	VERA	RAMADAN	DIANA	NJAZI	VALETA	VIKTOR	VLASH	PASHUK	TONIN	FRANCO
LIRI	AVNI	BESNIK	HAMIT	ELISABETA		ANILA	ISLAM	TEREZINA	PASHUK	ENVERIE	YMER
BEHARE	AGUSH	FATIME	HAMIT	SHPETIM	NJAZI	ARBEN	ISLAM	GASPER	PASHUK	NAIME	ALI
TATJANA	SAMI	FERHAT	HAMIT	DAVITA	PAL	ILIR	ISLAM	ALI	RAMO	IRIS	ENVER
VLADIMIR	SAMIR	LIRI	HAMIT	LIZAPAL		LINDITA	ISLAM	BAZE	RAMO	EDA	ENVER
NATASHASAMI		LUAN	HAMIT	NDUE	PALL	AVDYL	SHPEND	LELE	RAMO	BRUNILDA	ENVER
AVNI	XHELAL	SABRI	MEXHIT	PAVLIN	MHLL	SALISHPEND		NOVRUZ	RAMO	HYSEN	LUAN
NARUSHIE	XHELAL	MUNIR	MEXHIT	TEREZA	PRENGA	ALISSELAMI		REXHEP	RAMO	MIMOZA	LUAN
NEZIR	XHELAL	XHAHIT	MEXHIT	MENDUFKE	XHAFER	NIRMAN	SELAMI	VEZIRE	RAMO	ERALD	LUAN
BARIE	ISUF	DESTAN	MEXHIT	DHURATA	SELIM	QAZIM	SELAMI	SANIJE	RIZA	RENIS	LUAN
HAXHI	ISUF	MARIKA	SELIM	MARIKA	SELIM	ALEKSANDRA	ASTRIT	BEDRI	HIFZI	MEREME	IBRAHIM
NEBI	ISUF	MIMOZA	SELIM	MIMOZA	SELIM	GEUJI	ASTRIT	LAVDIJE	HIFZI	MENDU	PETRIT
ZARIFE	ISUF	MYZEJEN	SELIM	MYZEJEN	SELIM	SULLTANE	RAMAZAN	LINDITA	HIFZI	MYZEJEN	PETRIT
ANTON	GJOKE	RAJMONDA		RAJMONDA	SELIM	ZAN		LUTFI	HIFZI	HYQMET	PETRIT
BEPIN	GJOKE	SANIJE	SELIM	SANIJE	SELIM	LAVDIE	RAMAZAN	MEDIHA	HIFZI	BARDHE	BIB
LEONORA	GJOKE	SHKELQIM	SELIM	SHKELQIM	SELIM	RABIJE	HYSEN	VJOLLCE	HIFZI	PASHOK	JAK
GILMAN	ETHEM	VERUDE	SELIM	VERUDE	SELIM	HAMIDE	DULE	INGRID	AGIM	GENC	JAK
NEXHMILJE	ZYBER	FILIP	PRENGA	FILIP	PRENGA	PETREF	DULE	JETA	GAFUR	MARJAN	JAK
NIrvANA	ETHEM	GASPER	PRENGA	GASPER	PRENGA	PETRIT	DULE	MEDIHA	GAFUR	DAFINA	JAK
FATMIRA	MAHMUT	BESNIK	EMIN	BESNIK	EMIN	REPIT	DULE	ADHURIM	GAFUR	FATMIR	JAK
TAULANT	ALEKS	SHYQVRANE	REXHEP	SHYQVRANE	REXHEP	SKENDER	DULE	FERDINAND	KAJMAK	CESK	JAK
GIZELI	ALEKS	DILEGJON		DILEGJON		BASHKIM	DESTAN	MAK		VJOLETA	ALI
AGRON	SYRJA	DED	LLESH	DED	LLESH	FATMIR	DESTAN	SHPETIM	KAJMAK	LUAN	ALI
DILEPAL		DILEPASHK		DILEPASHK		PETRIT	DESTAN	FATIME	XHEVDET	BEQIR	ALI
GASPER	GJON	KOL	LLESH	KOL	LLESH	SHEMSI	DESTAN	GJYLJJE	XHEVDET	BARDHYLALI	
TONIN	GJON	HEDIJE	FEUZI	HEDIJE	FEUZI	DAVIDE	HAXHI	ILIR	XHEVDET	AFERDITA	SKENDER
VIKTOR	GJON	SADRI	COL	SADRI	COL	FATIME	MUSTAFA	TARIK	XHEVDET	RAZIJE	SKENDER
BASHKIM	BASRI	DHIMITRA	LLAZARAJ	DHIMITRA	LLAZARAJ	LUAN	HAXHI	ZOJE	MUSA	TEFTA	SKENDER
BUKURI	ARIF	ARAQ		ARAQ		LUMTURI	HAXHI	SANIJE	AVDI	XHELADIN	SKENDER
DIFEARIF		FILLORETA	JORGO	FILLORETA	JORGO	NAZI	HAXHI	OSMAN	AVDI	ALFRED	BAHRI
HAMIT	ARIF	KOZETA	LLAZARAJ	KOZETA	LLAZARAJ	XHEVAIR	HAXHI	AVDI	AVDI	MRIKE	
SABRIE	ARIF	MARJANA	LLAZI	MARJANA	LLAZI	SHYQVRANE		AHMET	AVDI	GENC	GJETE
FRAN	MHILL	NESTOR	LLAZARAJ	NESTOR	LLAZARAJ	LUTFIJE	HAZIS	HYKE	HAZIS	EDMOND	GJETE
LENE	MUSE	ANASTASIA	FARODIN	ANASTASIA	FARODIN	EDMOND	LILI	NAXHIJE	HAZIS	AGETINA	GJETE
LEZE	MHILL	DHIMITER	FARODIN	DHIMITER	FARODIN	EMIRJON	LILI	NAZIFE	HAZIS	FRANCESKINA	GJETE
LULE	MHILL	FAIKA	FARODIN	FAIKA	FARODIN	MAJ	LILI	RRUSHE	HAZIS	LILJANA	GJETE
BAJAME	REXHEP	MUKADEZ	FARODIN	MUKADEZ	FARODIN	BARDHE	NIKOLL	PRENA	JAK	DRITA	KOL
ENVER	REXHEP	SOFIJE	FARODIN	SOFIJE	FARODIN	DAVE	NIKOLL	LLESH	GJON	FREDERIK	MARK
MUHAREM	REXHEP	MARIO	FARODIN	MARIO	FARODIN	GJON	NIKOLL	MARK	GJON	XHULJANA	MARK
QAMIL	REXHEP	DOROTHEA		DOROTHEA		MRIKE	NIKOLLO	SOPIA	ZEQO	ARBER	MARK
SHEFIKATE	REXHEP	GEORGE		GEORGE		NDUE	NIKOLL	FERDIUS	ZALO	GARUFU	KOCI
NETI	QEMAL	LIGOR	GEORGE	LIGOR	GEORGE	PJETER	NIKOLL	VILSON	ALI	SUATE	SHERO
ENGJELLUSHE	QEMAL	DONIKA	GEORGE	DONIKA	GEORGE	VASILIKANIKOLL		FLORIDA	ALI	FERDINANT	XHEVDET
MIMOZA	QEMAL	PAVLO	GEORGE	PAVLO	GEORGE	ZEF		STEFAN	ALI	ANAPANAJOT	MENDUHLIJE
PELLUMB	QEMAL	ALEKSANDRA	NAPO-LON	ALEKSANDRA	NAPO-LON	TONE	LUCE	ZAME	REXHEP	BAJRAM	
SABIT	BASRI	ALI	HAMZA	ALI	HAMZA	EJELL	GJOK	LEDJA	SERVET	FATJONA	GEZIM
KADRI	BASRI	ARBEN	HAMZA	ARBEN	HAMZA	JORGO	ARISTOTEL	MAJLINDA		LORENA	GEZIM
MANUSHAQE	BASRI	ARDINAND	HAMZA	ARDINAND	HAMZA	KRISANTHI	ARISTOTEL	AFIFE	JASHAR	EDISON	NAMIK
HAMDI	HAZIS	BALLKEZE	FASLLI	BALLKEZE	FASLLI	SPIRULLA	ARISTOTEL	FLUTURA	FETI	ASTRIT	NASTRADIN
HALIL	HAZIS	FERDINAND	HAMZA	FERDINAND	HAMZA	MERITA	NEXHMEDIN	ILIR	FETI	SKENDER	NASTRADIN
HANE	HALIM	ADRIAN	NEXHMEDIN	ADRIAN	NEXHMEDIN	FATIME	HAMDI	BLERINA	FETI	MINERVA	SABRI
HIDIJE	HAZIS	FATIME	HAMDI	FATIME	HAMDI	NADIRE	HAMDI	MARASH	GJON	ARTUR	HAKI
LULZIM	HAZIS	NARD	LEK	NARD	LEK	NAILE	HAMDI	VERA	BESIM	APOLLONHAKI	
QAMIL	HAZIS	TONE	NDOC	TONE	NDOC	PASHK	GJON	ERVIN	ULIS	IRMA	HAKI
SAMI	HAZIS	VIKTOR	LEKE	VIKTOR	LEKE	RUSHIT	FUAT	AIDA	ULIS	ZENGJINE	VELI
SHKELQIM	HAZIS	ZEF	LEK	ZEF	LEK	MUKADEZ	FUAT	ESMA	DEMIR	SOFOKLI	FLAMUR
SHASHE	ZER	EMA	LEKA	EMA	LEKA	NAZMI	FUAT	EIMAZ	BARI	VALBONA	FLAMUR
ALBANA	MEHMET	ISMET	LEKA	ISMET	LEKA	HEKTOR	FUAT	ARGENT	BARI	MUR	
BESNIK	MEHMET	KRISAVGJI	KOLI	KRISAVGJI	KOLI	BATJAR	NEKI	BAJAME	BARI	ARREN	FLAMUR
HAZBIJE	MEHMET	ILIRJAN	ALFONS	ILIRJAN	ALFONS	BUJAR	NEKI	BESNIK	BARI	PARASHQEV	FLAMUR
SHPETIM	MEHMET	MARJO	ALFONS	MARJO	ALFONS	BUJAR	NEKI	JULIANA	BARI	MARSH	
MAJLINDA	SHYQYRI	AMIR	BEXHET	AMIR	BEXHET	RIZA	NEKI	MARIE	BARI	PAJTIM	FLAMUR
VJOLLCA	SHYQYRI	ERIDAN	BEXHET	ERIDAN	BEXHET	SHQIPONJA	NEKI	MYSHQERE	BARI	TONE	PREK
AYLFIQARE	ARIF	IKBALE	BEXHET	IKBALE	BEXHET	GJON	PJETER	SANIJE	IMER	ANGJELINA	KOL
ILIANA	STEFAN	NAGRIS	BEXHET	NAGRIS	BEXHET	MALIQ	SULEJMAN	HATIXHE	JAKUP	FRANCESKA	CAN
MURAT		ANA JORGI		ANA JORGI		PALINE	PJETER	ARIFE	JAKUP	FILIP	GJON
LUAN	MUHARREM	ILIA	JORGJI	ILIA	JORGJI	PALINE	PJETER	ASLLAN	JAKUP	HEKTOR	DHIMITER
RESMIJE	MUHARREM	THANAS	JORGJI	THANAS	JORGJI	LEZE	ZEF	REXHEP	JAKUP	VIVIANA	DHIMITER
ESAT	MUHARREM	BESNIK	SHUKRI	BESNIK	SHUKRI	NDOC	ZEF	SOKOL	JAKUP	CEZAR	KRISTAQ
XHEMIL	MUHARREM	DALISHUKRI		DALISHUKRI		VIDE	ZEF	XHEVAHIRE	JAKUP	SOFIA	REXHEP
YLAVIE	MUHARREM	FIZE	SHUKRI	FIZE	SHUKRI	LENA	KIN	ESMA	QAZIM	ALI	DEMIR
LAURA	NIKOLLA	SADIJE	SHUKRI	SADIJE	SHUKRI	BROZ	PASHUK	VESAR	MUSTAFA	FERIDE	DEMIR
TATJANA	AVNI	SHEFIJE	SHUKRI	SHEFIJE	SHUKRI	AGOSTIN	PASHUK	ALIDE	MUSTAFA	LEME	DEMIR

Opinion i Ditës

Paraja që i merret së ardhmes

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... nga ana e kompanive private. Ato që njihen sot si oferta të pakërkuara. Sikur këtë njoftim ta kishte bërë një vit më parë, në mars-prill 2018! Kur ish-kryetari i këtij komisioni, sot zvkrëministër ngrinte alarmin për 319 kontrata publike të dhëna pa garë, që po shkatërrojnë ekonominë. Kur Fondi Monetar Ndërkombëtar i kërkoi shprehimisht qeverisë të mos pranonte oferta të pakërkuara për tenderë për objekte dhe shërbime publike nga ana e kompanive private. Kur Banka Botërore ngriti shqetësimin se shteti mund vërtet të ketë kosto financiare më të mëdha me një partneritet publik-privat (PPP) të hartuar keq. Veçanërisht të atyre që lidhen me garancitë për të siguruar financim privat apo ribisedim kontratash. Kur po në prill 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit iu adresua Kuvendit dhe qeverisë dhe propozoi pezullimin e përkohshëm të partneriteteve publik-privat, me qëllim një analizë më të thelluar të raportit kosto-përfitim tek ato. Bazuar në një raport special të Gjykatës Evropiane të Audituesve (KLSH-së së Bashkimit Evropian), i cili ngrinte probleme të shumta me kontratat PPP në vendet e BE-së. Por nuk e bëri! Prandaj ky njoftim për këtë ndryshim në ligjin e prokurimeve publike vjen, për fat të keq, tepër vonë. Po pse nuk e bëri qeveria jonë, të themi në prill ose maj një vit më parë, me gjithë shqetësimet e ngritura dhe propozimet profesionale? Sepse ishte në valën e përgatitjes së shtatë projekteve-kontrata të mëdha koncesionare me formulën PPP të programit 1 miliard



euro. Qëllimisht nuk përfilli as këshillat e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, as edhe propozimin e KLSH-së. Katër nga këto shtatë projekte-kontrata të qeverisë rezultoi nga oferta të pakërkuara. Mes tyre edhe disa prej akteve të famshme rrugore me formulën PPP: Thumanë-Vorë,

Kardhiq-Delvinë, Orikum-Himarë dhe Milot-Balldren, të cilat së bashku me rrugën e Arbërit kushtojnë 720 milionë euro. Duke miratuar këto kontrata, qeveria do të nisë të na fusë dorën në xhep të gjithëve për një periudhë 13-15 vjeçare, që të paguajmë nëpërmjet taksave këto vepra, të cilat do të rreshkin shanset tona për zh-

villim dhe marrin shumë mundësi për investime në të ardhmen. Këto janë para që i merren së ardhmes së të gjithëve neve dhe që do të rëndojnë në xhepat e gjithsecilit prej nesh që paguan dhe do të paguajë taksat gjatë këtyre viteve. Janë shpenzime që rëndojnë gradualisht, si pa u vënë re, Buxhetin e Shtetit, duke rritur në

mënyrë të padukshme (nuk regjistrohen që tani si borxh) borxhin publik të vendit. Vitet e fundit janë ndërmarrë një sërë eksperimentesh të kushtueshme PPP për taksat-paguesit shqiptarë, sikurse është rasti i kontratës koncesionare/partneritetit publik-privat të "check-up"-it (kontrollit mjekësor të personave të moshës 40-60 vjeç), kontrata e ngjashme për sterilizimin e pajisjeve mjekësore, etj. Përmes këtyre kontratave, përmes një procesi në të cilin ka munguar këshillimi me publikun, duke e vendosur Parlamentin thjesht në rolin e një noterizuesi të vullnetit qeveritar, ka munguar transparencja mbi të dhënat e biznes-planëve të kompanive përfuturore të PPP-ve. Mbi të gjitha janë përzgjedhur kompani pa përvojën e nevojshme në sektor e në ndonjë rast edhe pa kurrfarë lidhje me të, por thjesht si rezultat i lobimit politik. Ky lobim ka bërë në këto tre vitet e fundit që shumta të konsiderueshme prej dhjetëra e qindra miliona eurosh nga taksat e qytetarëve gjatë tërë dekadës 2017-2026 të përthithen, me një kosto dy-tre herë më të madhe se sa po t'i kishte bërë vetë shteti, në llogaritë e kompanive të përzgjedhura në këtë mënyrë, shumica me ofertë të pakërkuar. Me kontrata tejet të diskutueshme për bazën e tyre ligjore, si dhe për faktin se rrisin 100 përqind i ngelet shtetit. Pra, nuk ekziston risk për palën e biznesit në këto kontrata. Kjo është kërdua që është bërë. Qeveria thjesht ka bërë njërin sy qorr e njërin vesh shurdh. Dhe tani, kur zaret janë hedhur dhe para që i merret së ardhshme sonë ka shkuar lumë, ndërton "gardhin" për më 1 korrik 2019 për ofertat e pakërkuara të biznesit privat. Si kofini pas të vjelit, thotë populli.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Dje në "Deutsche Welle"

Ndjenja pranverore gjermano-franceze

Nga Christian Trippe

(vijon nga faqja 1)

... dhe të krizave, për të rihedhur themelet me një akt simbolik të partneritetit. Edhe te shtetet puna nuk është ndryshe nga bashkëshortët. Shampanja që preferohet të ofrohet në raste të tilla të bie shpejt në kokë, por efekti i saj del shpejt.

Tani Gjermania dhe Franca trokasin në Ahen gotat për përtëritjen e partneritetit të tyre. Dhe kjo është më tepër se marrje me vetveten. Gjithmonë ka qenë pjesë e parimeve drejtuese të politikës së jashtme gjermane, që Republika Federale nuk duhet të ndodhet kurrë në një situatë, ku t'i duhet të zgjidhte midis SHBA dhe Francës. Ky parim bazë ka vlejtur që prej vitit 1949 për të gjitha koalicionet dhe kabinetet, dhe vazhdoi të vlejë edhe kur Gjermania u ribashkua në vitin 1990. Por tani peshorja duket se anon në mënyrë të qartë - në anën e Francës.

RIKALIBRIM I ALEANCËVE

Një vendim i kërkuar në mënyrë të ndërgjegjshme ky nuk ishte, të paktën për sa i përket anës së Berlinit. Por ja që në dy vjetët e fundit balancat janë zhvendosur në mënyrë dramatike. Vërtet që transatlantizmi ende nuk është katandisur në gërmadhe, por është i rrezikuar të pësojë kolaps - në sajë të Donald Trumpit. Sepse në atë masë që SHBA investojnë gjithnjë e më pak kapital politik për t'u kujdesur për aleancat e tyre, në atë masë rritet te partnerët e zhgënjyer distancimi, nis rikalibrimi i aleancave.

Marrëveshja e Elizësë, e cila përtërihet tani në Ahen, ishte në thelb një marrëveshje pajtimi midis dy vendeve, të cilat brenda 75 vjetësh zhvilluan tri luftëra shkatërrimtare kundër njëra-tjetrës. Në Marrëveshjen e Elizësë gjermanët shtuan atëherë me shpejtësi një preambul, në të cilën



vlerësohet rëndësia e marrëdhënieve transatlantike.

Në Marrëveshjen e Ahenit nuk ka hapa të tillë që dalin nga korinza. Ajo përforcon e bindur atë që është arritur, por ajo përdor në mënyrë të pazakontë shumë paragrafë për veprimet e përbashkëta politike. Për projekte të bashkëpunimit ushtarak, për fusha të bashkëpunimit ndërkombëtar, për institucione si Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Pak i koduar duket formulimi në nenin 4 të Marrëveshjes së re. Në të gjermanët dhe francezët përforcojnë premtimin për mbështetje ushtarake të NATO-s - gjë që do të ishte krejt e panevojshme, po të ishte vetëkuptueshme. Por që kur Presidenti aktual amerikan luan me idenë e daljes së vendit të tij nga aleanca ushtarake, që atëherë të gjitha siguritë politike ndodhen

NJË ÇËSHTJE FRANCEZËT E KANË MERAK

Gjermanët dhe francezët konstatojnë se "objektivat dhe strategjitë e tyre në politikën e mbrojtjes po afrohen gjithnjë e më shumë me njëra-tjetrën". Në Paris dhe në Berlin, në grupe të vogla ka kohë që vritet mendja, nëse dhe si mund ta sjellë Franca në miqësinë gjermano-franceze potencialin e saj bërtamor. Gjermanët nuk e kanë të lehtë të zbresin në reflektime të tilla strategjike.

Për palën franceze, ajo që ndodh tani në Ahen, ka rëndësi të madhe. Asnjëherë më parë në historinë franceze nuk ka pasur një qeveri, që të ishte fiksuar në një mënyrë të tillë në partneritetin me Gjermaninë. Po të dështojë Presidenti Emmanuel Macron dhe

me të projekti gjermano-francez, atëherë dështon Bashkimi Evropian. Pastaj, populistët i majtë Jean-Luc Melenchon dhe radikalja e djathtë Marine Le Pen do të kishin shanse të mira për presidencën franceze, dy persona që janë në mënyrë të vendosur antigjermanë dhe nacionalistë.

Kancelarja federale gjermane e cenuar politikisht i la shumë kohë vetes për t'i dhënë përgjigje iniciativës së Macronit për politikën evropiane - gjë që çoi në pakënaqësi në Paris. Me Marrëveshjen e Ahenit Angela Merkel jep tani një përgjigje. Po të mbushet me jetë kjo marrëveshje, gjermanët dhe francezët do të bënin një hap të madh në afrimin e politikës ndaj Europës. Do të ishte si një pranverë e dytë politike. Pse të mos i ecë Berlinit dhe Parisit, ajo me të cilën ka sukses edhe ndonjë çift tjetër në moshë?

HOROSKOPI

DASHI

Komunikimi do të jetë argëtimi juaj kryesor sot. Shpaloseni talentin tuaj në këtë drejtim. Sa i përket dashurisë, gjërat po ecin me ritme pozitive. Prisi zhvillime interesante në këtë drejtim.

DEMI

Merrni gjërat ngadalë dhe përpuni të mos jeni të paduruar me ndonjë marrëdhënie të re që po zhvillohet. Gjithkush duhet t'i bëjë gjëra me ritmin e tij ose të saj dhe ju duhet ta respektoni atë.

BINJAKET

Nëse jeni në gjendje shpirtërore për të takuar sa më shumë njerëz, atëherë bëjeni këtë! Do të keni shumë mundësi për të zgjeruar sot rrethin tuaj shoqëror. Mos u habitni nëse një takim i rastësishëm rezulton të jetë ribashkim me një mik të vjetër.

GAFORJA

Nëse jeni duke menduar të realizoni një investim, është mirë që të prisi edhe pak. Nuk favorizoheni në këto momente në çështjet financiare. Edhe në dashuri jo gjithçka po ecën mirë.

LUANI

Qëndroni i fokusuar te planet tuaja. Me ritme të gjada, por të sigurta gjithçka do t'ju ecë mbarë veçanërisht në aspektin profesional. Edhe në çështjet e dashurisë gjërat do ju shkojnë mirë.

VIRGJERESHA

Ka shumë hapësirë për kompromis mes asaj që dëshironi ju dhe asaj që dikush tjetër kërkon të bëjë, prandaj mos jini tepër dogmatik. Sigurisht, zbatimi i logjikës së ftohtë ndaj një situatë mund të krijojë një zgjidhje të drejtpërdrejtë, por kjo mund të mos mjaftojë..

PESHORJA

Sa më shpejt që të ngriheni këtë mëngjes, aq më shumë energji pozitive do të keni. Sot është dita juaj me fat në disa projekte ambicioze. Detyrat më të vështira do të duken si një sfilatë mode.

AKREPI

Zgjerimi i rrethit tuaj shoqëror është një ide e zgjuar sot, sepse ju do të mund të takoni të gjithë lojëtarë njerëzve. Bisedat e ndezura do të përqendrohen në përvojat e përbashkëta me disa njerëz të mrekullueshëm.

SHIGJETARI

Një personalitet, i cili është i gjatë në bisedime, por i shkurtër në veprime, do t'ju pengojë sot. Kujdes nga njerëzit që mburren me shumë, sepse ata vërtet punojnë fort. Taktika juaj më e mirë është që të përqafoni modestinë dhe të lejoni veprimet tuaja të flasin.

BRICJAPI

Përpjekjet tuaja të fundit për t'u lidhur me dikë po funksionojnë, por përpuni ta reduktoni pak nivelin e nxehtësisë. Bëjeni rezistencë dëshirës për të ndarë shumë informacione për veten tuaj.

UJORI

Çështjet e profesionit nuk ecin me ritmin që do të dëshironit. Mos e humbni shpresën, sepse gjërat e mëdha bëhen pak nga pak. Asnjë sukses nuk arritet brenda ditës. Kushtojni më shumë vëmendje shëndetit.

PESHQIT

Të qenit i kujdesshëm nuk do të thotë të jeni i mërzitshëm! Nëse doni aventura në jetën tuaj sot, bëjeni atë mënyrë të mençur dhe të sigurt. Mos bëni lojëra me fatin, por besoni më shumë të zëri i arsyes.

Trajneri i Partizanit habit pas ndeshjes në lidhje me afrimet

Gega: Çunat e kanë marrë seriozisht Kupën. Merkato? Shpresojmë të vijë ndonjë i saktë



Partizani fitoi në ndeshjen e parë kundër Kastriotit dhe trajneri Skënder Gega është i kënaqur me atë që të tijtë kanë dhënë në fushën e lojës, duke mundur 4-2 Kastriotin në fushën tejet të rënduar të stadiumit "Redi Maloku" të Fushë-Krujës.

Një fitore në një terren të vështirë...

Është ndeshje që normalisht ka problemet e

veta. Fusha ishte jashtë çdo norme për të dyja ekipet. Për fat të mirë çunat e kanë mar-

rë seriozisht ndeshjen dhe jam i kënaqur nga impenjimi dhe mënyra se si mori loja.

Po nëse vini për kampionat këtu dhe janë të tilla kushte?

Do të bëjmë atë që bëjnë të gjithë. Ne i kemi pranuar këto kushte, të cilat shpresoj që të

rregullohen.

Sinjale pozitive nga Hebaj dhe Rexhepi, je i kënaqur?

Është ndeshje kupe dhe mendova se një pjesë nuk e ka marrë minutazhin që duhet, kështu që vendosa të aktivizohen.

Merkato mbetet e hapur...

Klubi po punon, është pjesa e rëndësishme e merkatos. Do të shikojmë se çfarë do të ndodhë. Shpresoj të vijë ndonjë i saktë.

Sa i kënaqur je me rinovimin?

Kur kam ardhur, nuk kam premtuar se do të jem afatg-

jatë. Jam i kënaqur dhe i lumtur. I jam mirënjohës klubit, lojtarëve dhe presidentit. Do të mundohem të punoj me përkushtim.

Filloi Partizani të besojë te titulli?

Është punë e përbashkët, të gjithë besojmë te njëri-tjetri. Grupi po plotësohet, janë në gjendje optimale.

E shikoni skuadrën gati për ndeshjen e së premtes?

Faza përgatitore ishte e mirë. E respektojmë Skënderbeun, por jemi të gatshëm të marrim më të mirën.

Mposhtin respektivisht Kastriotin 4-2 dhe Besëlidhjen 2-1. Luhet në terrene të baltosura



Jeton Selimi

Partizani e Skënderbeu "OK", gati për përballjen e fundjavës

Verdiktet e dy ndeshjeve të para të Kupës së Shqipërisë

Partizani dhe Skënderbeu kalojnë pa shumë probleme ndeshjet e tyre të para të vlefshme për Kupën e Shqipërisë, teksa në transfertë kanë arritur të likuidojnë përkatësisht Kastriotin dhe Besëlidhjen, duke e bërë takimin e kthimit më komod, por mbi të gjitha duke filluar menjëherë pas vërshtëllimës së trefishtë, përgatitjet për kryendeshjen e javës së 19-të në Korçë, ku të premtën Skënderbeu do të presë Partizanin.

GJASHTË GOLA NË FUSHËN E BALTOSUR

Kastrioti-Partizani do të ishte një ndeshje interesante sidomos në pjesën e parë të saj, kur krutanët do të shënonin të parët me anë të Jergen Vatnikajt, sulmuesit të dalë pikërisht nga akademia e kuqe. Shtatlarti Vatnikaj do të shënonte një gol mjaft të bukur me kokë në minutën e 13-të, ndërsa më pas do të niste ofensiva e kuqe, që do të përmbyste shifrat që në 45 minutat e para me anë të golit të Rubin Hebajt në të 31-të dhe të Emanuel Mensh në të 42-ën. Duhet theksuar se kjo



ndeshje u zhvillua në një terren shumë të rënduar e të baltosur, ndaj dhe gabimet nga të dyja kampet ishin

prezente. Në pjesën e dytë Partizani dhe Kastrioti do të shënojnë 3 gola në harkun e pak minutave për të vultur

një rezultat përfundimtar 4-2 me Gegën, që gjithsesi kishte hedhur në fushë lojtarët me më pak minuta.

KUPA E SHQIPËRISË	
TE MARTEN	
GRUPI A	
Dje	
Kastrioti - Partizani	2-4
Besëlidhja - Skënderbeu	1-2
Sot	
Egnatia - Luftëtari	14:00
Vllaznia - Kamza	14:00
GRUPI B	
Sot	
Apolonia - Kukësi	14:00
Bylis - Laçi	14:00
Lushnja - Teuta	14:00
Tirana - Flamurtari	17:00

SKËNDERBEU MPOSHT BESËLIDHJEN
Skënderbeu ka mposhtur

Besëlidhjen me rezultatin 1-2 në takimin e vlefshëm për Kupën e Shqipërisë. Edhe pse luhej në një terren tepër të rënduar, skuadra korçare arriti të mposhte lezhjanët, duke hedhur një hap drejt turit të tretë. Nëshë Oton Xhon, ai që hapi serinë e golave në minutën e 10-të pas një asisti të Guexh, duke kaluar në avantazh të tijtë. Pavarësisht disavantazhit, vendasit e trajnerit Gjoni nuk u dorëzuan, teksa në minutën e 26-të barazuan shifrat me anë të Omar Kamara. Pjesa e parë u mbyll në barazim 1-1. Ndërkohë në minutën e 51-të, Gripsi gjeti sërish rrugën e rrjetës, duke u dhuruar fitoren korçarëve. Rezultati mbeti i pandryshuar deri në fundin e takimit, pavarësisht përpjekjeve të shumta të të dyja skuadrave. Sfida e kthimit do të zhvillohet pas 2 javësh në qytetin e Korçës.

ZËRAT NGA SPANJA

Marselo, Realit: Më lër të shkoj te Juventusi

Marselo te Juventusi është më shumë se disa zëra merkatoje. Shtypi spanjoll, më saktë "Marca" dhe "Sport", janë të sigurt se mbrojtësi i Realit e ka bërë të qartë dëshirën që do të largohet, me destinacion Torinon. "Nëse ata më bëjnë një ofertë konkrete, duhet të më lini të shkoj", - mësohet t'u ketë thënë braziliani drejtuesve të "galaktikëve", kërkesë e cila mund të mbushet, pasi në Spanjë gjithashtu raportojnë se presi-



denti Perez është gati për një revolucion në ekip, edhe nëse këtë vit fitojnë sërish Championsin, duke parë momentet jo të mira që po kalon ekipi këtë sezon. Zërat për një kalim të Marselos te Juventusi ekzistonin edhe gjatë verës, por në fund ky transferim nuk u arrit dot. Me kalimin e muajve, mediat kanë raportuar se "shkes" për këtë operacion, po bëhet edhe Kristiano Ronaldo, që e do me vete tek Juventusi Marselon.

Lëvizja që habiti opinionin


Boateng: Ëndërr të luaj për Barcelonën



të një ëndërr, po pres me padurim të luaj për Barcelonën dhe të bëj maksimumin që të ndihmoj këtë skuadër. Për

shumë lojtarë është ëndërr të luash në këtë klub, por ky është edhe vërtetimi se po punove mirë, ëndërr mund të bëhen realitet", - deklaroi Boateng pas prezantimit si futbollist i katalanëve. Boateng do të kalojë sot testet mjekësore dhe do të paraqitet më vonë në "Camp Nou". Futbollisti gazez mund të përfshihet në listën e të grumbulluarve për ndeshjen e Kupës së Mbretit kundër Sevillas, këtë të mërkurë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Pupi regjisor.
- Turner aktore.
- Fillojnë festat.
- Skuadër greke.
- Falen pa fe.
- U shkrua nga Gorkij.
- Një sferë për... model.
- Janë bisha.
- Parashtesë për dy.
- Demoni që persekutonte Sarën.
- Stacion i famshëm orbital.
- Mendes regjisor.
- Një rreth i ngushtë miqësor
- Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- Këndohen në opera.
- Është lajm i vjetër.
- Sharif aktor.
- Martin i Norma Rae.

- Mund të jenë filmi.
- Një jepet për hartim.
- Ami i Maupassant.
- Fundi i Turandot.
- Hailii këngëtare.
- Neill i Jurassic park.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Giorgio stilist

VERTIKAL

- Morissette këngëtare.
- Kilmer aktor.
- Heche aktore.
- Fillojnë tatëpjetën
- Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- Mbyllin spitale.
- Në krye të masave.
- Bëjnë shirit me shi.
- Qe vajza e Tantalit.
- Janë më shumë se dëshira
- Ishte dekret i sulltanit.
- Qe mbreti i urtë i Pilos.
- Quinn aktor.
- Gasol i NBA.
- Fillojnë garën.
- Një pjesë e reformave.
- Është si biskotë
- Mund të jetë karmelitan.
- Sjellin shi.
- Bel i Maupassant.
- Direk pa ekstreme.
- Gjysma e bimëve.
- Mbyllin një motor.
- Është bitum.
- Fara këngëtare.
- Hanks aktor
- Stiller aktor.
- Morrison rockstar.
- Fillojnë masat.
- Në krye të tabelës.
- Derisa janë në fund.
- Fund filmi.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Film i hitchock.
- Fillojnë premierën.
- Janë legjendat.
- Kush ka... ka zët.
- Thurman aktore.
- Një pjesë e testamentit
- Një pjesë e studimeve.
- Kështu është situata e tensionuar.
- Telefoni në kartëvizitë.
- Është ngasje.
- Në krye të autoriteteve.
- Mbyllin mbledhjen.
- Pason abetaren.
- Nisin nga kreu.
- Fillojnë aafirimin.
- Cocker këngëtar.
- Bartok kompozitor.
- Tiriac që qe tenist.
- Oxa këngëtare.


- Kalimi në ekstreme.
- U shkrua nga Zola.
- Fise pa fe.
- Është mballomë.
- I mungon apatikut.
- Një pjesë e medaljeve.
- Një këngëtar lirik.
- Pak torturues.
- Ka privilegjin e jetës.
- I famshmi Pacino.
- Nasi shkrimtar.
- Janë temperaturat më të ulëta.
- Me pit në box.

VERTIKAL


- Janë enigmatikë.
- Emri i Vivaldit.
- Rrjedh në klepsidër.
- Inicialet e Selleck aktor.
- Fillojnë rubrikën.
- Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.
- Vitet pa kufij.
- Mbyllin kanate.
- U shit për një pjatë thjerza.
- ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- Moore aktore.
- Rocca aktore.
- Janë përmasa.
- Fund dhjetori.
- Mbyllin krahun.
- Fillojnë kalimin.
- Duhen ruajtur.
- Ishte Europa komuniste.
- Agjenci Kombëtare Lokale
- Berg kompozitor.
- Të parat në Amsterdam.
- Elsa këngëtare.
- Memoria në computer
- Me të nxjerrin trarë.
- Në mes të dhomës.
- Ekstreme kateti.
- Kufijtë e lutjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		8	4	2				
	7			9		8	6	
		2			1	3		
3								
5	7		6		9	1		
	2			5				
	8	4						
6			1				8	5
							2	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	7	1	4	5	6	3	9	8
3	6	4	1	8	9	7	2	5
5	9	8	2	3	7	1	4	6
6	1	9	5	2	3	8	7	4
7	8	5	6	9	4	2	1	3
4	2	3	7	1	8	5	6	9
8	4	2	9	7	5	6	3	1
9	5	7	3	6	1	4	8	2
1	3	6	8	4	2	9	5	7

Argëtim filozofik

- Gruaja e Sokratit, me të cilën ai martua rreth moshës 50 vjeçare, ndoshta më shumë ngaqë donte fëmijë sesa grua. Ajo ishte grindavece dhe fjalëshumë. Kur u inatos një herë me Sokratin i hodhi një kovë me ujë dhe Sokrati tha: "E dija që bubullimat e Ksantipit do të sillnin më pas edhe shiun".

- Gabimi i bëri kafshët njerëz; a është në gjendje e vërteta ta ribëjë njeriun kafshë?

- Ai që i tërbon njerëzit kundër tij, gjithnjë fiton një pjesë të tyre në anën e tij.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20			
3	2	6	5	3	2	1	5	1	13	1			
21		4	3	5	6	2	1	5	5	10	5		
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1	5		
2	13	7		2	1	5	1		1	2	8	1	K
	19	1	7	3	5	6		15	14		10	6	A
13	3	5	2		5	6	11	1	1	1	5	T	
5	2			21		19	6	2	1	5	1		
1	5	7		6	2	8	5	10	8	6			
16	8	7	8	17	6	5		1	6		21	6	
6			15	8	5	1	5		18	3	10		
4	3	18	8	7	6		18	6	4	6	7	1	

- Ti e harron fajin tënd kur ia tregon një tjetri, por zakonisht tjetri nuk e harron.
- Askush nuk flet më me shumë pasion për të drejtën e tij sesa ai që, në thelb të shpirtit, ka një dyshim për të drejtën e tij.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

RODGETPETER
 ODLUANETKAKA
 MMELOPOMENIDI
 AAEPALAMEIDI
 RLARASNOB
 RIOAKKTANBD
 ZETAATUSOELI
 SPIIFARISEJ
 ATAMFIFICHE
 RIRUMJOSON
 ATALBOSTNI
 LIUATIEGDA

D **S** **H** **A** **K** **L** **E** **D**
E **M** **O** **N** **T** **E** **L** **L** **A** **I**
P **S** **U** **G** **O** **R** **D** **O** **N** **P** **Y** **M**
E **M** **E** **P** **A** **R** **M** **E** **N** **I** **D** **I**
R **O** **T** **A** **R** **E** **B** **E** **L** **D**
S **U** **O** **M** **I** **E** **T** **A** **P** **A**
E **L** **I** **O** **T** **S** **I** **R** **A** **N**
T **I** **L** **E** **K** **A** **L** **E** **N** **D**
N **A** **R** **E** **N** **H** **I** **R** **T**
A **S** **A** **A** **T** **A** **T** **U** **R**
R **R** **E** **T** **H** **S** **O** **U** **R**
T **O** **A** **L** **L** **I** **N** **O** **T** **A** **I** **T**

Thënie të mençura

- Kur njeriu ulurin nga e qeshura e madhe, ua kalon të gjitha kafshëve me ultësinë e tij.
- Njerëzit janë më të ndjeshëm kur përcmohen nga të tjerët sesa kur përcmohen nga vetja e tyre.

